




Koha

www.koha.mk



KOHA për enigma

Fq. 12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3357 · e shtunë/e diel 5-6 maj, 2018

9°C | 14°C

15 DEN

AKTUALE

Muzeun e Alfabetit e zë mallkimi i emrit



Pas miratimit të këtyre katër projekteve nga IPA dhe nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit mes partnerëve realizimi ka ngecur, duke u shtyrë muaj pas muaji nënshkrimi i kontratës, nga ana e palës greke. Se çfarë po ndodh nuk është në gjendje ta shpjegojë as drejtori i Muzeut të Alfabetit, Nuer Arslani...

Fq.5

GLOBI

Letër Trumpit: Po rikthehet depresioni i madh

Fq.17

RAJON

Hoxha: Tahiri po foli, qeveria do të rrëzohet

Fq.16



SFIDAT E AGJENCISË OPERATIVE TEKNIKE

SI DO TË PËRGGJOHET NË MAQEDONI?



Qeveria së fundmi ka lidhur një memorandum bashkëpunimi me Qendrën për kontroll demokratik të forcave të sigurisë (QKDS) nga Gjeneva e Zvicrës. Krejt kjo për të ndihmuar organin më të ri për zbatimin e përgjimeve, Agjencinë operative teknike, e cila u themeluar me ligj të veçantë para disa ditësh në Parlament. Reformat në sektorin e shërbimeve të inteligjencës, siç njoftuan nga Qeveria, të dy trupat pritet ta zbatojnë Brenda periudhës 2017-2020

Fq.3

UNT programe të reja dhe bursa për studentët

Shkup, 4 maj – Ditëve të hapura, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup u ka shtuar edhe elementin e festiv, pasi krahas promovimit të ofertës akademike për vitin 2018/2019 aktiviteti në fjalë është shoqëruar nga një varg organizimesh që lidhen drejtpërdrejtë dhe tërthorazi me rastin. Dita e premte nisi në UNT me Konferencën shkencore “Emigracioni, Mobiliteti dhe Politikata Sociale”, për të vijuar me hapjen e standave të

pesë fakulteteve në Sheshin “Skënderbeu” në Çarshi të Vjetër, nga ku në mënyrë të organizuar nxënësit dhe gjithë të interesuarit janë dërguar të vizitojnë hapësirat në të cilat organizohen studimet. “Edhe pse Shkupi është njëri prej qyteteve me numrin më të madh të shqiptarëve, ishte i fundit që fitoi të ketë universitet në gjuhën shqipe. Por ja që ia dolëm dhe sot kemi jo vetëm universitetin në gjuhën shqipe...

Fq.4



EDITORIAL

A DO TË KEMI ZHVILLIM TË BARABARTË?



Emin AZEMI

Ata që kalojnë nëpër Maqedoni, para vetes u dalin dy peizazhe—kontrast: pjesa Perëndimore, e pyllëzuar, e gjelbëruar dhe e populluar, dhe pjesa Lindore, e zhveshur dhe gati e braktisur.

Këto janë ndarjet që i ka bërë natyra dhe njeriu e ka të vështirë ta konkurrojë natyrën, mirëpo njeriu mund ta fisnikërojë atë. Në pikëpamje demografike e urbane vërehet një asimetri e skajshme, për shkak të migrimit të madh të popullsisë nga Maqedonia Lindore në Shkup. Prandaj, jo rastësisht për Shkupin thuhet se është gati e gjithë Maqedonia.

Politika demografike e urbane e Maqedonisë edhe në këtë drejtim ka qenë e padrejtë ndaj banorëve të saj. Në njërin anë ka nxitur migrimin (maqedonas) fshat—qytet, në anën tjetër ky migrim ka qenë më i orientuar drejt Perëndimit (shqiptarët). Mërgimtarët maqedonas të ardhur nga Maqedonia Lindore në Shkup u bënë "padronë" të mëdhenj, kurse mërgimtarët shqiptarë të Maqedonisë Perëndimore u bënë rrogëtarë të metropoleve evropiane.

Por, Maqedonia Perëndimore edhe sot e kësaj dite është më e bukur, më e gjallë dhe me një urbanistikë rurale për çdo lakmi. Parazitizmi maqedonas me vite të tëra kishte prodhuar "njeriun e shtetit", i cili punonte në stilin "tun e ha" dhe harxhoi ardhmërinë e vet duke ia kthyer shpinën fshatit për një trohë snobizëm industrial në kryeqytet. Atje la vetëm disa pleq, si thëngjij gjysmë të ndezur, që japin do shenja jete.

Dehumanizimi, i cili erdhi si pasojë e urbanizimit të paplanifikuar krijoi përshtypjen e rrejshme, se ata që zotërojnë Shkupin, zotërojnë krejt Maqedoninë. Por, në fakt në Shkup u krijua vetëm një oligarki ekonomiko-politike, kurse pjesa tjetër u proletarizua deri në palcë. Proletarët e tillë sot i shohim tek protestojnë para ndërtesës së qeverisë, tek kërkojnë t'u shpërblehet statusi i të falimentuarve. Kjo sepse në Maqedoni me vite kishte falimentuar ideja e zhvillimit proporcional të rajoneve.

Shteti kishte investuar disa projekte kapitale ekonomike e industriale në Maqedoninë Lindore, ndërkohë që rrugët, kanalizimet, shkollat në fshatrat e Maqedonisë Perëndimore ua kishte lënë në duar private shqiptarëve. Konkurrimi i investimit shtetëror dhe ai privat një kohë ishte shumë disproporcional, sepse në njërin anë shteti hapte fabrika dhe vende pune për mijëra punëtorë maqedonas, kurse në anën tjetër, shqiptarët me paratë e kurbetit asfaltin rrugë, hapnin kanalizime dhe ndriçonin sheshet e fshatrave të tyre. Tani shteti nuk po hap fabrika, por shqiptarët janë ata që po e mbushin arkën e shtetit. Potencia fiskale e shqiptarëve, asnjëherë nuk është kalkuluar politikisht dhe pikërisht këtu kanë dështuar partitë politike shqiptare. Në fakt, shqiptarët në Maqedoni paraqiten investitorë të dyfishtë: në njërin anë duke investuar në ekonominë e tyre private dhe në anën tjetër duke shtuar potencën fiskale të shtetit, përmes qarkullimeve pagesore në sektorin e gastronomisë, telefonisë mobile, auto-salloneve, derivateve të naftës, duhanit, materialeve ndërtimore etj.

Nëse një shtet si Maqedonia ka zhvillim joproporcional dhe nëse në atë shtet një pjesë e popullsisë jeton nga të ardhurat që i siguron vetë, atëherë medoemos duhet hartuar një politikë tjetër makroekonomike. Në kushte të tilla shteti duhet t'i orientojë investimet andej edhe nga vijnë harxhuesit dhe paratë. Në rrethanat e këtushme do të ishte absurde të mos investohet në pjesët e banuara me shqiptarë dhe është e padrejtë që shqiptarët të trajtohen vetëm si kontingjente të freskëta fiskale dhe asgjë më tepër. Në të kundërtën, ka të ngjarë që parazitët e deridjeshëm pa asnjëfarëllor mudi të vazhdojnë të sillen si "padronë" me paratë e shqiptarëve. Maqedonia asnjëherë nuk mund të jetë një shtet i barabartë për të gjithë nëse drejtuesit e ri të shtetit me politikën e tyre zhvillimore zbatojnë standarde e dyfishta, si pararendësit e tyre, apo ndoshta ka të ngjarë që ta prishin këtë traditë të keqe të imtimit.

Nëse Saimir Tahiri paska qenë një peshk i vogël!

"Nëse Saimir Tahiri paska qenë një peshk i vogël, siç po thuhet, atëherë rrugë të mbarë gjuetisë së "peshkaqenëve", pavarësisht krahut që kanë zgjedhur për të qëndruar në oqeanin e zullumit! Nuk ka fare rëndësi, nëse janë shefa apo kundërshtarë të tij. Cilado qoftë arsyeja e dorëzimit të tij tek drejtësia, ata që bëjnë prej kohësh gjumë të trazuar, për shkak se e dinë ç'kanë bërë, kanë një arsye më shumë të shikojnë ëndrra të keqija. Të paktën nuk qëndron më alibia se mbrojtja e ish-ministrit me imunitet ishte një barrikadë e fortë për pandëshkueshmërinë. Dhe kjo nuk ka të bëjë shumë me atë që mund të thotë apo tregojë vetë Tahiri gjatë hetimit të tij. Më tepër se kaq, është djegia e një etape tjetër në një proces me sa duket të pakthyesëm, dhe me shumë gjasë ky është shkak se pse po përvëlton kaq shumë. Është ai momenti, kur e ndjen se po të ngrihet niveli i ujit dhe ti e di që nuk mund të notosh, ngaqë t'i kanë lidhur duart", ka komentuar në një profil në Facebook, dorëheqjen e Saimir Tahirit, deputeti i PD-së, Astrit Patozi.

Ironia e në proteste

"Të gjithë ne protestë apo ne "luftë", Tetova e Kazinove dhe e "narko bareve" Kazinot dhe narkobandat nën ombrellen e politikës dhe institucioneve kriminale lokale po shndërojnë Tetoven në një qytet ku krimi godet në palcë pjesën me vitale të kombit. Ironia me e madhe e kesaj proteste janë perfaqesuesit politik që ne aparence shfaqen si perkrahës por në margjina janë mburoja e gjithë kriminalitetit që ka ngerthyer Tetovën. Ata janë mbyroja e zyrtareve policore që stimulojnë delikencen duke u lene duart e lira krimineleve te nentokes te operojne me lokale, kazino dhe pazare narkotikesh ne afersi te qendrave studimore edhe me keq ne afersi te shkollave te mesme ku ndjeshmeria e moshes eshte me delikate. Krimi i organizuar dhe nëntoka e mbrojtur nga perfaqesues politik po e shndërojnë Tetovën në Nje Las Vegas jo te shtrire ne shkretetirën e Perendimit të eger por ne një hapësirë që përballet me probleme te medha socio - kulturore dhe ekonomike", ka shkruar në profiling e tij në Facebook, gazetari Nexhbedin Shaqiri.

Rezultati i zgjedhjeve lokale në Britani të Madhe

"Votat janë ende duke u numëruar në disa komuna por rezultatet bëjnë me dije se këto zgjedhje kanë sjellur ndryshime të vogla në pushtetin lokal. Laburistët e kanë shtuar numrin e këshilltarëve por ky fakt nuk rezulton në shtimin serioz të numrit të komunave. Njësoj është edhe me konservativët: dikund kanë humbur e dikund kanë fituar. I vetmi ndryshim ka ndodhur me UKIP që është një parti me tendencë ekstreme të së djathës apo nacionaliste. UKIP në zgjedhjet e kaluara, para katër viteve, patën marrë 17% të pushtetit lokal kurse sipas rezultateve të sotshme kanë rënë në nivel pothuaj joekzistues pasi që deri në këtë moment ata kanë vetëm dy këshilltarë dhe duket se do të jetë kështu edhe pas numërimit final të votive", shkruan në profilin e tij në Facebook, studiuesi nga Londra, Daut Dauti

MEDIACitate

Synimet e NATO janë drejt bazave detare në Shqipëri

SHBA po jep sinjale se nuk është e kënaqur me situatën politike në Itali, ku ndodhet baza kryesore e NATO-s në këtë rajon. Qeveritë aty po ndryshojnë shpesh dhe SHBA po hedh sytë në vende të tjera për të ngritur baza ushtarake, ku vëmendja është drejt Shqipërisë. Teksa Moskë vazhdon tentativat për të ndikuar në Ballkanin Perëndimor dhe për ta larguar atë nga sfera e influencës së Perëndimit, vende si Italia nën tensionet pas-elektorale kanë ende dilemat e tyre në lidhje me aleancat ndërkombëtare. Një nga vendet që e ka bërë të qartë zgjedhjen e saj është Shqipëria, një orientim i konfirmuar nga vizita e ministres Olta Xhaçka në Pentagon, e pritur nga sekretari James Mattis, i cili e mbushi me lavdërimet atë dhe vendin e saj. Shqipëria është anëtare e NATO nga viti 2009 dhe sot dëshiron të konsolidojë lidhjet euro-atlantike me një bazë amerikane ose të NATO në vend. Synimet e NATO duket se janë drejt bazave detare. Në takimet në SHBA, Xhaçka është pritur shumë ngrohtë. "Në takimin me Mattis, Xhaçka e ftoi të merret në konsideratë Shqipërinë si vend kontakti në rajon, duke shtuar se "ne kemi disa ide mbi vënien në dispozicion të tokës sonë hapësirës ajrore e bazave detare, si në mënyrë bilaterale ose nëpërmjet NATO. Konkretisht ministrja mendon për krijimin e një baze ushtarake të bashkë-menaxhuar nga Shqipëria e SHBA, ose në sferën e një baze detare të NATO", thuhet më tej. Vendosija e një baze ushtarake në Shqipëri do të dëmtojte Italinë. Gatishmëria e Shqipërisë si platformë për operacionet ushtarake të NATO nuk kufizohet në përforcimin e gatishmërisë ushtarake perëndimore në Evropë, por dhe do të ndihmonte në evitimin e hezitimeve nga vende të tjera si Italia, ku influenza e SHBA është shpesh objekt debati politik. Mungesa e seriozitetit të politikës italiane vë në dyshim rolin e vendit në aleancat ndërkombëtare. Ministrja shqiptare kërkon në Pentagon baza të NATO NATO dhe SHBA nuk janë të kënaqur me Italinë dhe tani si alternativë po shihet Shqipëria. Megjithatë ministrja ka sqaruar se ajo thjesht ka bërë një ofertë dhe është vendimi amerikanëve të vendosin.

(Revista "Formiche", 4 maj)

NËSE NUK E KENI DITUR...

PËRSE QENTË HANË BAR?

Shkencëtarët mendojnë se për qentë është krejtësisht normale të hanë bar dhe se kjo nuk ka të bëjë me sëmundje as me mungesë ushqimi. Dobia e barit për qentë qëndron në atë që u ndihmon në nxjerrjen jashtë të parazitëve nga zorrët. Materia që përmban fibra në bar shkakton tendosje të madhe të zorrëve dhe lehtëson dukshëm nxjerrjen jashtë nga zorrët të parazitëve. Natyrisht, ekziston edhe shpjegimi shumë i thjeshtë përse qentë hanë bar—thjesht e duan shijen e tij. Qentë të gjithë i kemi parë që

përtypin me dashuri barin, madje disa prej tyre e kanë bërë pjesë të rutinës së tyre të përditshme. Për fat të mirë, shumica e ekspertëve besojnë se kjo nuk është diçka që ju duhet të shqetësohen. Qentë nuk janë vetëm mishngrënës, ata mund të marrin lëndët ushqyese edhe nga burimet tjera të ushqimit përveç mishit, duke përfshirë manaferrat, perimet, madje edhe nga bari. Megjithatë, arsyeja më e mundshme që qentë hanë bari është sepse ata kanë stomak të dobët.

Qeveria së fundmi ka lidhur një memorandum bashkëpunimi me Qendrën për kontroll demokratik të forcave të sigurisë (QKDS) nga Gjeneva e Zvicrës. Krejt kjo për të ndihmuar organin më të ri për zbatimin e përgjimeve, Agjencinë operative teknike, e cila u themeluar me ligj të veçantë para disa ditësh në Parlament. Reformat në sektorin e shërbimeve të inteligjencës, siç njoftuan nga Qeveria, të dy trupat pritet ta zbatojnë Brenda periudhës 2017-2020

SFIDAT E AGJENCISË OPERATIVE TEKNIKE

SI DO TË PËRGJOHET NË MAQEDONI?



Organi i autorizuar	Fillon-propozimi për zbatim të masës hetuese
Porokuroria	Jo ose po
Gjykatësi i procedurës paraprake	Jo ose Po -lëshon urdhër për zbatimin e masës hetuese
Agjencia Operative Teknike	1. Administron masën hetuese, 2. Inspekton vendin e hetimit 3. Vendos pajisje për përgjim
Qëllimi	Përgjimi

në Maqedoni viteve më herët. Që në fillim kur duhet të nisë zbatimin e ligjeve në sferën e sigurisë, Qeveria e re kryesuar nga LSDM ka dhënë shenja se e ka seriozisht në realizimin e këtij misioni dhe të mos përsërit gabimet e qeverive të mëhershme kur dhe ajo vetë ishte në pushtet kur dhe ndodhi rasti Sopotit. Qeveria së fundmi ka lidhur një memorandum bashkëpunimi me Qendrën për kontroll demokratik të forcave të sigurisë (QKDS) nga Gjeneva e Zvicrës e cila ka partneritet me qeveritë e shumë shteteve në Botë shteteve, parlamentet, shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe palë tjera nga sektori i sigurisë, përfshirë nëpunës policor, gjykatës, agjenci hetimi, forca të armatosura e kështu me radhë. Krejt kjo për të ndihmuar organin më të ri për zbatimin e përgjimeve, Agjencinë operative teknike, e cila u themeluar me ligj të veçantë para disa ditësh në Parlament. Reformat në sektorin e shërbimeve të inte-

ligjencës, siç njoftuan nga Qeveria, të dy trupat pritet ta zbatojnë Brenda periudhës 2017-2020. Ndihma e(QKDS) kryesisht është në aspektin praktik në teren, zhvillojnë dhe promovojnë norma të përshtatshme demokratike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përfaqësojnë praktikën më të mirë dhe propozojnë politika që mundësojnë udhëheqje demokratike të sektorit të sigurisë. Sipas Ligjit të ri për ndjekjen e Komunikimeve Kërkesë për realizimin e masave të veçanta hetimore mund të parashtrijë Prokuroria publike kompetente ose personi i autorizuar i policisë gjyqësore deri tek gjyqtari i procedurës paraprake. Gjyqtari i procedurës paraprake do të vendos me se voni 48 ore nga parashtrimi i kërkesës. Ndërkaq

zbatimin e masës së veçantë hetimore do ta realizojë Agjencia teknike operative (ATO). Siç thotë zëvendësministri i punëve të Brendshme Agim Nuhiu, ATO do të posedojë kushte teknike për ndjekjen e komunikimeve për hetime penale dhe për mbrojtjen e interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit. "Agjencia do të ketë Drejtorin e saj që do të zgjidhet nga Parlamenti me 2/3 e votave dhe me Badinter. Në këtë mënyrë do të kemi një drejtor që do të duhet të sigurojë edhe mbështetjen e deputeteve shqiptarë", thotë Agim Nuhiu. Me Ligjin për ATO, thekson Agim Nuhiu, parashikohen të punësohen punonjës operativ, punonjës profesional dhe punonjës teknik operativ. "Jemi të bindur se

mekanizmi i vettingut në një formë të caktuar do të zbatohet në punësimet e reja sidomos kur do të jetë në pyetje kredibiliteti profesional dhe moral, duke përfshirë edhe pastërtinë e figurës së punonjësit konkret, zotohet kështu Agim Nuhiu. Është me rëndësi të themi, shton ai, se ATO do të ketë mbikqyrje nga Parlamenti duke dorëzuar Raporte për numrin e komunikimeve të aktivizuara për të gjitha organet, për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, gjendjen e konstatuar nga mendimet dhe udhëzimet gjatë kontrolleve profesionale ndaj operatorëve, numrin e procedurave disiplinore, etj", thotë Agim Nuhiu. Ndryshe po sipas ligjit të ri për ndjekje të komunikimeve, organi kompetent pranë Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim, konkretisht inspektori i DSK-së, indiciet për personin caktuar dhe faktet që posedon e lajmëron Prokurorinë. Prokuroria ka të drejtë të refuzojë ato që parashtron Inspektori i DSK-së, ose të vendosë që të vazhdojë procedura. Më pas prokuroria parashtron kërkesë deri tek gjykatësi i procedurës paraprake për të ndjekë masa të veçanta hetuese ndaj personit të caktuar. Gjykatësi i procedurës paraprake vendosë të refuzoj se të pranojë kërkesën e prokurorisë, nëse po atëherë Zbatimin e masave hetuese e bënë Agjencia Operative Teknike. Pas periudhës së caktuar për përgjim, materialet e përgjuara shkojnë në Prokurori dhe ajo mund të ngrit ngritë aktakuzë kundër personit të përgjuar.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 4 maj- Reformat në shërbimin inteligjent bashkë me reformat në gjyqësor do të jenë ndër matësi kryesor të cilësisë së qeverisjes të garniturës aktuale në pushtet. Së fundmi u miratuan dy ligj të rëndësishme Miratimit ai për ndjekjen e komunikimeve dhe ligjit të ri për dëshmitar të mbrojtur. Përmes të parit kompetenca për përgjim nga DSK kalohet në Prokurorinë publike ndërsa përmes të dytit Prokuroria Speciale i jepet mundësia që vetëm ti përcaktojë personat për dëshmitar të mbrojtur duke mos qenë e varur siç ishte deri më tani nga Prokuroria Publike. Me këto dy ligje vetëm se filloi misioni për reformimin dhe modernizimin organeve të sigurisë në vend dhe misioni për të zbardhur të vërtetën e se kush përgjoi në mënyrë të paligjshme

BASHKËPUNIM TEJKUFITAR PËR EUROPEERSPEKTIVAT E BALLKANIT PERËNDIMOR

E ndajmë fatin e njëjtën me BE-në, por ende nuk jemi në tryezë, deklaroi shefi i diplomacisë së Maqedonisë, Nikolla Dimitrov në takim të tretë katërpalësh ministror të Maqedonisë, Greqisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë, i cili u mbajt të premten në Selanik.

"Politikisht ne jemi pjesë e BE-së, gjeografikisht tani më jemi atje, e ndajmë fatin e njëjtë ekonomik në lidhje me tregtinë dhe investimet e njëjta. E ndajmë fatin e BE-së, por nuk jemi me të vërtetë në tryezë", tha Dimitrov, në takim të cilin morën pjesë edhe shefat e diplomacive të Greqisë, Shqipërisë dhe të Bullgarisë.

Ai e falënderoi ministren bullgare të Punëve të Jashtme Ekaterina Zaharieva dhe kryeministrin bullgar Bojko Borisov, për atë që si vend kryesues me Unionin kanë arritur rajonin ta kthejnë në agjendën politike të BE-së, ndërsa



vitin 2018 ta bëjnë vit të mundësive.

"Në takim kemi dy vende kandidatë dhe dy vende anëtare. Besoj se nuk mund të bëhemi një vend me të vërtetë i gëzueshëm nëse rajoni nuk lëviz në drejtim të përbashkët", tha Dimitrov dhe shtoi se ngjarjet e tanishme janë moment pozitiv për tërë rajonin.

Koxias në hapjen e takimit porositi se sfidat në korniza botërore e detyrojnë rajonin e EJT-së ta rrisë integritetin.

"Ndryshimet që po ndodhin në botë çojnë deri në konkludimin se duhet ta intensifikojmë dhe thellojmë bashkëpunimin midis vendeve të EJT-së", tha Koxias.

Ai përmendi se thellimi dhe ba-

shkëpunimi i mëtejshëm është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të dy qëllimeve, "IRJM"-ja dhe Shqipëria të bëhet pjesë e BE-së dhe të mundësohet përgatitje për bashkëpunimin i tyre në kuadër të Unionit.

Shfaqja shpresë që kjo iniciativë, të cilën e ka ngritur Greqia para rreth dy vjet e gjysmë është ringjallur dhe është bërë traditë.

Propozoi përforcim të bashkëpunimit në përballjen me çështjen për refugjatët dhe kontrollin kufitar, por edhe bashkëpunimin e qendrave universitare dhe hulumtuese, në energjetikë dhe infrastrukturë.

Shefave të diplomacive të katër vendeve do t'u bashkohen edhe ministrat e transportit dhe të punëve të brendshme. Tema të takimit janë bashkëpunimi tejkufitar për europerspektivat e Ballkanit Perëndimor, për ndikimin e ngjarjeve të

Lindjes së Afërt ndaj rajonit, mundësitë për zhvillimin e infrastrukturës rrugore. Do të bëhet fjalë edhe për bashkëpunimin midis policive, luftën kundër krimit tejkufitar dhe të organizuar dhe përballjen me emigracionin. Shefat e diplomacive të Maqedonisë dhe të Greqisë, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxias, sot do të kenë takim të ri bilateral në kuadër të takimit ministror. Takimi është një mundësi për vazhdimin e bisedimeve për zgjidhjen e kontestit afatgjatë për emrin. Pas takimit është paraparë deklarata e ministrit të Punëve të Jashtme të Maqedonisë.

Dimitrov dhe Koxias sërish duhet të takohen edhe javën e ardhshme në konferencën ndërkombëtare që do të mbahet në vendin Sunio, në afërsi të Athinës. Takimi ministror do të përfundojë me konferencë të përbashkët për shtyp.

Nga viti akademik 2018/2019, UNT do të nis aplikimin e sistemit të bursimit. Nga pesë bursa, me 100 për qind lirim do të ndahen ekskluzivisht për studentët e Velesit. Ndërkaq, bursa në kategorinë e 100, 70 dhe 50 për qind lirim do të ndahen për studentët nga Shkupi. Për të fituar këta bursa kandidatët e interesuar do garojnë në lëndët e matematikës dhe shkencave natyrore, që do të organizohen ditën e shtunë, më 5 maj. Në të ardhmen bursat do të zgjerohen në të gjitha qytete, thotë Bilgin Ajredini nga zyra arsimore e UNT-së

Koha Laura PAPARNIKU

Shkup, 4 maj – Ditëve të hapura, Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup u ka shtuar edhe elementin e festiv, pasi krahas promovimit të ofertës akademike për vitin 2018/2019 aktiviteti në fjalë është shoqëruar nga një varg organizimesh që lidhen drejtpërdrejtë dhe tërthorazi me rastin. Dita e premte nisi në UNT me Konferencën shkencore "Emigracioni, Mobiliteti dhe Politikë Sociale", për të vijuar me hapjen e standave të pesë fakulteteve në Sheshin "Skënderbeu" në Çarshi të Vjetër, nga ku në mënyrë të organizuar nxënësit dhe gjithë të interesuarit janë dërguar të vizitohen hapësirat në të cilat organizohen studimet.

SHPALOSET OFERTA AKADEMIKE NË "DITËT E HAPURA FESTIVE"

UNT PROGRAME TË REJA DHE BURSA PËR STUDENTËT



"Edhe pse Shkupi është njëri prej qyteteve me numrin më të madh të shqiptarëve, ishte i fundit që fitoi të ketë universitet në gjuhën shqipe. Por ja që ia dolëm dhe sot kemi jo vetëm universitetin në gjuhën shqipe por edhe një institucion të arsimit të lartë me programe tepër atraktive dhe që nxjerrin kuadro për të cilët ka nevojë tregu i punës në Maqedoni", thotë prof. Dr. Bekim Fetaj, prorektor për çështje shkencore në UNT. Pavarësisht moshës së re, sa i përket ekzistimit, UNT do të begatojë gamën e studimeve që ofron me programe të reja për fitin e ardhshëm, sikurse janë drejtimit e Programimit, Shpeditonit dhe Doganës, Tekstilit, Modës dhe Dizajnit apo Nanoteknologjisë. "Fokusi i punës tonë është që të ofrojmë programe të cilat nuk gjenden në universitete tjera të krijuara

mbi bazën e analizës për kërkesat e tregut të punës", sqaron Fetaj.

Arsyeja që Konferenca shkencore u organizua në të njëjtën ditë me atë të shpalesjes së ofertave akademike, sipas Bilgin Ajredinit, përgjegjësit të zyrës arsimore në UNT, nuk është e pa qëllimshme. "Donim ta shfrytëzojmë rastin që gjatë vizitës së hapësirave tona, nxënësit dhe prindërit të mund të shohin nga afër se si zhvillohen punimet në një konferencë shkencore. Për këtë arsye, u vendos që të dyja këto ngjarje të jenë në të njëjtën ditë", shprehet Ajredini. Ndërkaq, risia tjetër e këtij viti, thotë se janë bursat e studentëve. Nga viti akademik 2018/2019, për pesë studentët nga Velesi UNT do të ndajë nga bursa ekskluzive për ta me 100 për qind lirim nga pagesa e katër viteve të studimit, edhe atë tre për studente

vajza dhe dy për djem, me qëllim të nxitjes së arsimimit të lartë të të rinjve që jetojnë në këtë zonë aspak favorizuese për shqiptarët e Maqedonisë. Do të ndahen gjithashtu bursa në tre kategori për kandidatët nga Shkupi, me 100, 70 dhe 50 për qind lirim për studentët nga Shkup. "Këtë vit, meqë janë bursat e para, jemi kufizuar vetëm me nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit, ndërsa në të ardhmen do të zgjerohemi në të gjitha qytete e Maqedonisë", tregon Ajredini. Këto bursa do të fitohen nga kandidatët në garën nga matematika dhe lëndët e shkencave natyrore që do të zhvillohen ditën e shtunë, më 5 maj. Në bazë të interesimit të nxënësve që kanë shprehur dëshirë të marrin pjesë në këtë garë, nga shkollat e mesme të Shkupit ishin dërguar listat me emrat e 75 nxënësve, të cilët do të fitojnë bursën varësisht pikëve që do të fitojnë në garë.

I themeluar në dhjetor të 2015-ës, Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup nis punë në tetor të 2016-ës. Ofron 30 programe studimore (22 të akredituara nga viti i kaluar dhe 8 për të cilat pritet të merr lejen e akreditimit javën e ardhshme). Të gjitha këto programe janë të shpërndara në Fakultetin e Teknikës, Fakultetin e Teknologjisë, Fakultetin e Informatikës, Fakultetin e Arkitekturës dhe Ndërtimtarisë dhe Fakultetin e Shkencave Sociale.



"Dhuro gjak, shpëto jetë"

Shkup, 4 maj – Me moton "Dhuro gjak, shpëto jetë", shkolla e mesme e Qytetit të Shkupit "Marija Kiri Skllodovska", Instituti i mjekësisë së transfuziologjisë, Kryqi i Kuq dhe Komuna Çair, për të gjashtë herë me radhë organizuan aksion për dhurim gjaku në Çifte Hamam në Shkup. Kiril Kacarski, përfaqësues nga Instituti i transfuziologjisë, tha se është një aksion për të vetëdijësuar qytetarët, për dhurimin e gjakut, që të ndihmojnë njerëzit në nevojë. Ky aksion sipas Kacarskit vazhdon edhe në qendrat përkatëse të Maqedonisë.

"Me dhurimin e gjakut shpëtohet jeta e njerëzve. Pasi të grumbullojmë sasinë e gjakut, që e dhurojnë njerëzit e shëndoshë, epruveta kalon në shumë procedura, ku edhe testohet çdo njësi e paketimit të gjakut, për siguri më të madhe. Instituti ynë punon intenzivisht dhe në mënyrë efikase bazuar në normat e Organizatës ndërkombëtare të transfuziologjisë, me qëllim të mundësive për të patur gjak cilësor, në ndihmë jetës së njeriut, me ç'rast përcaktojmë edhe nivelin e grupeve dhe produktet e gjakut – "plazmë", "gjak plotësues", "trumbocite", etj", tha Kacarski nga Instituti i mjekësisë së transfuziologjisë, për gazetën Koha.

Për dhurimin e gjakut paraqiten kategori të ndryshme të njerëzve, ku njëherësh ata kontrollohen dhe çdo pas çdo dhurimi të gjakut, një mostër e gjakut të dhuruesit testohet në laboratorë për praninë eventuale e infeksioneve të transmetueshme transfuzive (ITT), siç janë: Hepatiti B, Hepatiti C, HIV dhe sifilizi, sqaron Kacarski. Moshë e dhuruesve të gjakut është nga 18–65 vjeç, kurse ata që dhurojnë gjak çdo vit stimulojnë duke u dhënë mirënjohje, certifikata. Sipas organizatorëve personi që gjatë viteve ka dhuruar gjak më së paku 10 herë, ka beneficione në shërbimet mjekësore të shtetit. Vedat Mustava, drejtori i shkollës "Marija Kiri Skllodovska", bëri apel që gjithë qytetarët që kanë shëndet të plotë të bashkëngjiten aksionit dhe të dhurojnë gjak për të shpëtuar jetë. Xheladin Koka, polic me profesion, ka dhuruar gjak 10 herë dhe thotë se kjo është një mënyrë për t'i ndihmuar njerëzit në nevojë. Ndërsa, Vlladimir Iliqi, një vullnetar i devotshëm në Kryqin e Kuq, thotë se qindra herë ka dhuruar gjak, ku edhe është bërë një dokument në radio Televizion e Maqedonisë, për jetën e tij si njeri humanitar. (D.K)

MANÇEVSKI: TË DEPOLITIZOHET ADMINISTRATA

Tetovë, 4 maj – Kryetari i kuvendit të Maqedonisë dhe Ministri për Shoqëri të Informatikës Damjan Mançevski, kanë marrë pjesë në hapjen e konferencës me temë "Menaxhimi me sektorin publik, sfidat dhe perspektivat", që organizohet nga ana e fakultetit të shkencave shoqërore bashkohore në bashkëpunim me Insitutin "Maks van der Shtul", në kuadër të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë.

Sipas Ministrit Mançevski, riorganizimi i administratës publike është proces që rrjedhë gjithnjë me qëllim që të sigurohen shërbime më efikase, më të thjeshta dhe më të lira për qytetarët. "Për këtë qëllim është bërë strategjia e re për reformat e administratës publike në të cilën adresohen një numër i madh i problemeve për të cilat flasin qytetarët. Ajo për kerë të parë deri më tani është në një plan konkret aksionar, indikatorë përmes të cilët do të mund që të ndiqet se sa është përmishur, si dhe sigurim të buxhetit edhe përmes burimeve të brendsh-



me por edhe me ndihmë nga jashtë. Në Maqedoni ne edhe deri më tani kemi pasur shumë strategji për reforma në administratën publike, por këto strategji kanë mbetur vetëm shkronja në letër, pa një plan konkret aksionar, indikacione si dhe financime të pasigurta. Tani çdo institucion e din se çfarë duhet të bëjë" tha Mançevski. Fjalë rasti përpara të pranishmëve në këtë konferencë mbajti Kryetari i kuvendit Talat Xhaferi i cili theksoi se arritja e prioritetëve strategjike për antarësim të plote në Bashkimin Evropian dhe NATO nënkupton reforma në shoqërinë që

përfshinë edhe administratën publike. "Këto reforma dhe ndryshime në mënyrën për qasje, metodologjinë e punës së organizimit të administratës publike nuk e bëjmë vetëm për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe Natos, por e bëjmë që të arrijmë diçka tjetër shumë më të rëndësishme, për mirëqenie të qytetarëve tanë për të krijuar kushte për jetë dhe punë. Dhe këto rolin kryesor e luan administrata publike që duhet të jetë efikase dhe pasqyrë reale për hapat e përbashkët" tha Xhaferi. Rektori i UEJL-së si Zamir Dika tha se edhe pse ka përpjekje se-

riozë për bashkëpunim rajonal, si një aspekt dominues i ndërveprimit mes vendeve tona, megjithatë ka akoma mangësi në kompetencën qytetare dhe kapitalin shoqëror. Sipas tij, vërehet një nivel i ulët i pjesëmarrjes qytetare efektive dhe besimi politik, që e bën të nevojshëm vazhdimin e zbatimit të politikave të diversitetit. "Mungesa e rritjes ekonomike, identifikimi konstant i varfërisë, mosreformimi i sistemit të drejtësisë, departizmi i administratës, korrupsioni dhe papunësia, polarizimet sociale, nuk mjaftojnë të regjistrohen vetëm si shqetësime nëse nuk ndërtohet një strategji efikase nacionale që do të eliminonte një nga një këto dobësi", tha rektori Dika. Para të pranishmëve me fjalë rasti është paraqitur edhe ambasadori i Sllovenisë në Maqedoni Milan Jazbec përfaqësues të OSBE-së si dhe profesor Universitarë pjesëmarrës në këtë konferencë ndërkombëtare pubimet e së cilës do të zgjasin deri nëse kur edhe do të publikohen rezultatet të arriturat nga kjo konferencë. (U.H)

PREZANTOHEN VIDEO-PAMJET E 27 PRILLIT

ZBULOHEK QËLLIMI I VRASJES SË ZIJADIN SELËS

Nga sekuencat e prezantuara të premtën, opinionimi më i gjerë pati mundësi të shohë se si Ziadin Sela, fillimisht ishte goditur nga një shtizë druri. Si pasojë e kësaj goditje, prokurori Darko Jakimovski, sqaroi se i dëmtuari Sela rrëzohet për toke dhe më pas i njëjti ngritët duke e mbajtur kokën e gjakosur me dorën



në masë të madhe e vërtetoi aktakuzën e ngritur kundër dhjetë të akuzuarve, me çka në pamjet e prezantuara qartë shihej si Kire Gjeorgjievski, Aleksandar Janevski, Andrej Micov, e të tjerë, bëjnë orvatje për ta goditur deputetin Sela. Nga sekuencat e prezantuara të premtën, opinionimi më i gjerë pati mundësi të shohë se si Ziadin Sela, fillimisht ishte goditur nga një shtizë druri. Si pasojë e kësaj goditje, prokurori Darko Jakimovski, sqaroi se i dëmtuari Sela rrëzohet për toke dhe më pas i njëjti ngritët duke e mbajtur kokën e gjakosur me dorën.

Paralelisht me sulmin ndaj Ziadin Selës, i cili nga këto pamjet e publikuara deri më tani vërehet se si qëndron në qosh të Press Qendrës në Parlament, truma e dhunshme vërehet si vazhdimisht kërcënonte dhe ofendonte. Nga këto pamje po ashtu u vërtetua edhe goditja nga të akuzuarit Andrej Micov (me këmishë të zeza dhe "fantomkë") dhe Kosta Dellov, të cilët me grushta dhe gjësende të ndryshme i godasin truporjat e Zorav Zaevit dhe Oliver Spasovskit. Përderisa autori i vërtet i hedhjes së shtizës nga e cila deputeti Sela, mori goditje të rëndë në

kokë, nuk është i njohur për Prokurorinë, pamjet e prezantuara të premtën treguan se si i akuzuari Kire Gjeorgjievski, tejet i shqetësuar e hedh një mbetje metale të karrigeve në drejtim të Ziadin Selës. Manovrimi me dorë dhe kërcënimet ndaj Selës nga ana e Kire Gjeorgjievski, siç vërehet në video xhirimet e prezantuara nga Prokuroria, vazhduan edhe më pas. Gjatë shfaqjes së kësaj prove (video materiali) prokurori Darko Jakimovski, tha se mund të vërehet qartë se pas disa goditjeve, i dëmtuari Sela është në gjendje të rëndë, i gjakosur dhe ndërkohë në

këto rrethana një person ende i panjohur për organet e rendit e tërheq Selën nga grupi i deputetëve. Në këtë mënyrë vjen në shprehje edhe i akuzuari Aleksandar Janevski-Toshta, i cili në fillim të videos shihet se si vihet në mbrojtje të deputetëve, bashkë me deputetin Vllatko Gjorçev. Mirëpo, siç theksoi Trupi gjykues, i njëjti nga pamjet e ngadalësuar mund të vërehet se pikërisht është ai njëri ndër personat që e largon Selën nga grupi i sulmuar i deputetëve. Ndaj këtyre konstatimeve të prokurorisë dhe gjykatës, reagoi edhe pala mbrojtëse të cilat thanë se kjo video nuk tregon qartë akuzat ndaj e klientëve të tyre, respektivisht të gjitha akuzat e prokurorisë bazohen në supozime.

Në seancën e radhës për rastin Sela, pritet të prezanton si dëshmitari edhe vetë kryeministri aktual Zoran Zaev, deputeti i VMRO-DPMNE-së, Vllatko Gjorçev, ish truproja e Zaevit, Aleksandar Trajkov etj.

Ndryshe, në procesin e deritanishëm gjyqësor për rastin Sela, deklaratat e tyre para Gjykatës i kanë disa dëshmitarë, të cilën para opinionit rrëfyejnë rolin e të akuzuarve, posaçërisht të të akuzuarit Kire Gjeorgjievski dhe Aleksandar Janevski-Toshta.

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 4 maj - Në mungesë të kryeministrit Zoran Zaevit, i cili të premtën ishte i paraparë të paraqitet si dëshmitar në rastin Sela, Prokuroria Publike e Shkupit, para të pranishmëve prezantoi një video xhirim, të pa publikuar deri më tani, ku shihej qartë goditje e njëpasnjëshme ndaj kreut të Aleancës për Shqiptarët. Video materiali i prokurorisë, i përbërë prej një minutë e disa sekondash,

NJË VIT PAS MIRATIMIT TË FONDIT IPA

Pas miratimit të këtyre katër projekteve nga IPA dhe nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit mes partnerëve realizimi ka ngecur, duke u shtyrë muaj pas muaji nënshkrimi i kontratës, nga ana e palës greke. Se çfarë po ndodh nuk është në gjendje ta shpjegojë as drejtori i Muzeut të Alfabetit, Nuer Arslani, por nuk përjashtohet as mundësia që zvarritjet të vijnë si reflektim negativ të çështjes së kontestit të emrit me shtetin fqinj dhe marrëdhënieve që tensionohen herë pas here mes dy vendeve

Muzeun e Alfabetit e zë mallkimi i emrit



Koha Evis HALILI

Shkup, 4 maj - Projekti për rindërtimin e Muzeut të Alfabetit në Manastir, edhe pas miratimit të fondit nga Programi i Zhvillimit IPA akoma nuk ka nisur. Ka kaluar më shumë se një vit kur akordimi i grantit, prej më shumë se 300 mijë euro, akoma nuk është vënë në dispozicion të muzeut. Projekti për rindërtimin e muzeut të alfabetit, si pjesë e Programit për bashkëpunimin ndërkufitar "Muzetë lidhin kultura dhe njerëzit", ka si bartës dhe partnerë komunën e Volvos në Greqi, së bashku me Muzeun Olimpik në Selanik, shoqatën Triagolnik në

Shkup. Pas miratimit të këtyre katër projekteve nga IPA dhe nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit mes partnerëve realizimi ka ngecur, duke u shtyrë muaj pas muaji nënshkrimi i kontratës, nga ana e palës greke. Se çfarë po ndodh nuk është në gjendje ta shpjegojë as drejtori i Muzeut të Alfabetit, Nuer Arslani, nëse bëhet fjalë për një reflektim negativ të çështjes së kontestit të emrit me shtetin fqinj dhe marrëdhënieve që tensionohen herë pas here mes dy vendeve.

"Në fakt as unë nuk e kam të qartë se pse po ndodh. Nuk jepet asnjë arsytim nga pala greke, jemi në pritje çdo muaj, por akti final i nënshkrimit të kontratës po shtyhet

pas dhënë shpjegime. Komuna e Volvos është bartësja e këtij projekti që është financuar nga BE dhe është ajo që duhet që të lëvizë përpara këtë proces. Ja, tani na kanë caktuar një datë të re, 7 maj për nënshkrimin e kontratës, por prapë-prapë asgjë nuk është e sigurt. Ndërsa në mesin e këtij muaji në hotel Epinal këtu në Manastir do të zhvillojmë një takim mes të katër partnerëve", thotë drejtori Nuer Arslani. Miratimi i projektit për restaurimin e Muzeut të Alfabetit ishte lajmi më i mirë për këtë institucion, që prej funksionimit dhe themelimit të tij si muze për afro dhjetë vjet. Dhe mundësia e vetme që me anë të këtij komoditeti financiare që kjo godinë të rikthehet në identitet pas përpjekjeve të dështuara në vite për të rikonstruktuar pjesë të veçanta, por edhe për ta pajisur me teknologji bashkëkohore. Po ashtu godina do të duhet të jetë gati deri në muajin nëntor, kur këtë vit shënohet edhe 110 vjetori i Kongresit të Alfabetit.

"Projekti është i plotë, i kompletuar në të gjitha pikat, parashikon dinamikën e punës, afatet... dhe duhet të përfundojë brenda një pe-

riudhe të shkurtër. Pra ne jemi gati për rikthimin e kësaj godine në identitet, por edhe për bashkëpunimin me partnerët e tjerë të projektit dhe shkëmbimin e eksperiencave në sferën e aktivitetit muzeal. Mund të them se ne jemi muzeu i parë në Maqedoni që financohemi nga Programi IPA dhe projekti i vetëm në sferën e kulturës që u miratua prej tyre", thotë Arslani. Projekti rikonstruktues, që me marrjen me qera edhe të katit të parë të ndërtesës nga ana e Ministrisë së Kulturës parashikon rehabilitimin e plotë të këtij institucioni nacional që funksiononte në kushte jo të përshtatshme, por edhe trajnimin e stafit, krijimin e kushteve të sigurisë fizike të objektit për të parandaluar incidentet nga ana e ekstremistëve në këtë qytet, ku më e fundit ishte tentativa për t'i vënë flakën ndërtesës. Shtëpia ku u zhvillua Kongresi i Manastirit u hap dhjetë vjet më parë, atëherë kur edhe 22 nëntori, Dita e Alfabetit, u bë pjesë e kalendarit të festave. Projektet rikonstruktuese deri tani janë mbështetur nga Ministria e Kulturës, por pa arritur të krijojnë kushte minimale për të funksionuar si muze.

KRONIKË

Gjendet granatë në Xhepçisht

Tetovë, 4 maj- 40 vjeçari Q.B nga fshati Xhepçisht, të enjten rreth orës 16 e 40 minuta ka denoncuar se duke kryer punë në ndërtimtari, duke shembur mur në oborrin e shtëpisë së tij ka një granatë të kalibrit 100 milimetër. Granata e gjetur e cila ka qenë e ndryshkur është fotodokumentuar dhe është dorëzuar në drjetorinë për mbrojtje dhe shpëtim për procedurë të mëtejshme.

Aksidentohet

16 vjeçari nga Sllatina

Tetovë, 4 maj- Të enjten mbrëma rreth orës 21 në rrugën Marshall Tito, veturë e tipit Mercedes, me targa të Tetovës e drejtuar nga 33 vjeçari F.A nga fshati Zhelinë ka aksidentuar një 16 vjeçar i cili ka qenë duke drejtuar biçikletën e tij. Me të njejtën veturë 16 vjeçari është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës ku është mbajtur për kurim të mëtejshëm.

Aksidentohet 7 vjeçari

Tetovë, 4 maj- Në rrugën lokale që lidh fshatin Zhelinë dhe Leshticë e Poshtme, të enjten rreth orës 13 veturë e tipit Audi ka aksidentuar një 7 vjeçar nga fshati Zhelinë. 7 vjeçari është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës ndërsa policia punon në gjetjen e autorit të këtij aksidenti.

Për një muaj nga komunikacioni u larguan 68 vetura

Tetovë, 4 maj- Zyrtarët e policisë në SPB Tetovë, gjatë muajit të kaluar (prill) në Tetovë dhe rrethinë për shkak të kundërvajtjeve të ndryshme kanë përjashtuar nga komunikacioni me urdhër gjithsej 219 vozitës dhe 68 vetura. Numri më i madh i vozitësve që janë larguar nga komunikacioni janë 117 vozitës pa leje adekuate për vozitje, 91 vozitës të rinj të cilët nuk u janë përmbajtur kufizimeve të parapara me ligj, ndërsa 10 vozitës nuk kanë pasur kategorinë e përshtatshme sipas llojit të veturës që kanë drejtuar, thonë nga policia e Tetovës. "Në mes të vozitësve të cilët drejtojnë pa leje për vozitje, një numër i konsiderueshëm janë pjesëmarrës në transportin publik të udhëtarëve dhe më së shpeshti ata kanë drejtuar taksi kombi ose minibusë. Drejtuesve të larguar nga komunikacioni u janë pengaditur kundërvajtje adekuate, të parapara me Ligjin për siguri në komunikacion dhe rrugë, dhe do të përballen me gjo-ba të cilat lëvizin prej 200-300 euro në kundërvlerë të denarit. Nga veturat e përjashtuara nga trafiku, shumica e tyre gjegjësisht 68 janë për skadim të regjistrimit, deri dhe mbi 30 ditë, ndërsa tek 14 vetura janë konstatuar paregullsi teknike, para së gjithash në paisjet e frenimit, ndërsa tek një veturë është konstatuar mbingarkimë, ku kundërvajtësit do të ballafaqohen me gjo-ba të cilat lëvizin prej 100-500 euro në kundërvlerë të denarit. Përndryshe, krahasuar me muajin prill të vitit të kaluar, numri i vozitësve dhe veturave të përjashtuar nga trafiku në rajonin më të gjërë të Tetovës, ka pësuar një rënie ku numri është zvogëluar për pesëdhjetë kundërvajtje", njoftuan nga policia.

Incident në QS "Jane Sandanski"

Shkup, 4 maj - MDy shkupjanë dje pasdite fizikisht kanë sulmuar një të punësuar në Agjencinë e sigurimit në hyrje të qendrës sportive "Jane Sandanski", ndërsa gjatë intervenimit janë sulmuar edhe dy policë, pas çka sulmuesit janë dërguar në stacionin policor.

"Në qendrën sportive 'Jane Sandanski', në hyrje të sallës, gjatë kohës së ndeshjes së basketbollit midis ekipeve 'MZT Shkupi' dhe 'Rabotnicki' mbrëmë rreth orës 17:45, shkupjani J.B (24) dhe A.D (33) fizikisht kanë sulmuar S.N., të punësuar në Agjencinë e sigurimit, ku ka kryer detyrat zyrtare si sigurim i ndeshjes, me ç'rast i ka shkaktuar lëndime fizike", thuhet në buletin të policisë.

Gjatë intervenimit nga ana e zyrtarëve policorë, janë sulmuar edhe dy policë, pas çka sulmuesit janë dërguar në stacionin policor. Pas zbardhjes së plotë të rastit dhe dokumentim të ngjarjes, do të ndërmerren masat e duhura. (MIA)

PAS 12 VITESH RRËNOHET SHTËPIA AFËR GJYQIT

Tetovë, 4 maj- Kanë kaluar pothuajse 12 vite që kur në Tetovë është hapur bulevardi i Ilindenit. Atë kohë, janë rënuan shumë objekte përgjatë këtij bulevardiqë shfrytëzoheshin si lokale gjegjësisht Baraka për të cilat pronarët ishin kompensuar për shpronësimin e tyre për shkak se ato hapësira nevojiteshte të shfrytëzohen për hapjen e bulevardit. Por përgjatë gjithë kësaj kohe, ka qenë një shtëpi ku ishte e vendosur një këpuçar e cila nuk ishte rënuar. Aksioni për rënimin e së njejtës është bërë të enjten mbrëma pas mesnate kur edhe qarkullimi është më i vogël në këtë rrugë. Autoritetet e komunës së Tetovës thonë procedura për rënimin edhe të këtij objekti që gjendet përgjatë këtij bulevardit është stërzgatur për shkak të kontestit pronësor-juridik në mes të pronarëve dhe komunës, lëndën gjyqësore të këtij kontesti e ka fituar komuna dhe tanimë ai objekt është rënuar dhe në atë pjesë nuk do të hasen më problemet me të cilat ballafaqoheshin si vozitësit poashtu edhe këmbësorët për qarkullimin e lirë në atë pjesë të bulevardit të Ilindenit. Përndryshe kjo shtëpi ishte e



vetmja në këtë pjesë të qytetit që nuk ishte rënuar për vite me radhë. Kjo parqiste vazhdimisht pengesë për qarkullim të lirë të komunikacionit në këtë pjesë të qytetit ku edhe vazhdimisht krijohet kaosi për shkak të rrugës së ngushtë. U deshën 12 vite të kalojnë që kjo shtëpi të rënohet dhe të hapet rruga ashtu siç duhet si për automjetet poashtu edhe për këmbësorët. Rënimin filloi pasi që komuna ka fituar procesin maratonik gjyqësor me dy pronarët e kësaj shtëpie. (U.H)

Kryetarit i Lëvizjes Gashi

takohet me kryetarin e Gjilanit, Lutfi Haziri

Të premtën kryetari i Lëvizjes Besa, Afrim Gashi, ishte në vizitë të kryetarit të Komunës së Gjilanit, njëherazi nënkryetar i LDK-së, Lutfi Haziri.

Arsyeja e vizitës ishte vendosja e urave të komunikimit mes Lëvizjes Besa dhe LDK-së, ndërsa kryetari Gashi - edhe si deputet i zonës së dytë zgjedhore, u interesua edhe për bashkëpunimin në nivel komunal.

Duke vlerësuar orientimin politik, z. Haziri shprehu gatishmëri dhe vullnet të mirë që ta intensifikojë bashkëpunimin ndërpartiak dhe ndërshqiptar, gjithë kjo në kuadër të vlerave të përbashkëta, por edhe synimit të përbashkët për integrim euro-atlantik.

(Burimi: Lëvizja BESA)



BDI: Taravari heq dorë nga përkujdesi ndaj shkollave

Gostivar, 4 maj - Nga marrja e kompetencave, Taravari ka hequr dorë nga kujdesi institucionet arsimore, edhe pse, Komuna e Gostivarit është themeluese dhe e ka për obligim të kujdeset për mbarvajtjen e procesit edukativo-arsimor, thuhet në reagimin e BDI - dega e Gostivarit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës - MASH i ka hequr të drejtën për emërim dhe shkarkim të drejtorëve, por jo edhe kompetencat e tjera që ia garanton ligji. Për kaq kohë, Kryetari i Komunës së Gostivarit institucionet arsimore i keqpërdori vetëm për tu fotografuar, për organizimin e ekskursioneve, fotografimin e nxënësve dhe organizimin e maturës, kjo, me të vetmin qëllim interesin material për grupet e tij të interesit.

Rast eklatant është rasti me nëndrejtoreshën e Shkollës së Mesme Ekonomike Komunale, e cila, matu-

rantëve u imponon për mbrëmjen e maturës grupin muzikor të bashkëshortit dhe djalit të saj, për kundër dëshirës së maturantëve.

Ndërkohë, përkujdesi institucional i Komunës së Gostivarit sa i përket mbarvajtjes së procesit edukativo-arsimor në shkollat publike, thuhet nuk ekziston. Për kundrazin, institucionet e themeluara nga Komuna e Gostivarit, siç është rasti me Ndërmarrjen Publike Komuna - NPK "Komunalec", kanë filluar një fushatë represioni ndaj shkollave, duke ua bllokuar llogaritë bankare për faturat e papaguara.

Aktualisht, Shkollës së Mesme Komunale - SHMK, Gjumnazi si dhe Shkollës Fillore "Ismail Qemali", në Gostivar u janë bllokuar llogaritë bankare nga kjo ndërmarrje që drejtohet nga kuadri i Taravarit, thuhet në reagimin e BDI - dega e Gostivarit.

Tetovë, Dita e dallimeve kulturore

Tetovë, 4 maj- Java e dallimeve kulturore që tanimë tradicionalisht për të tetën herë me rradhë nga shoqata Multikultura ka kurorëzuar aktivitetet me "Ditën e dallimeve" aktivitet ky që në vete ngërthen panairin e shkollave të mesme, promovimin e organizatave joqeveritare, këndin e fëmijë, këndin e ushqimit, ekspozita dhe aktivitetet të ndryshme me karakter kulturor. Edhe vullnetarët e shoqatës Multikultura janë shprehur jashtëzakonisht të kënaqur me aktivitetet të cilat vite me rradhë organizohen nga shoqata Multikultura pasi që këto aktivitetet mundësojnë afrimin e të rinjve të nacionaliteteve të ndryshme për të promovuar vlerat dhe kulturat e gjithësecilit. Përndryshe Java e dallimeve kulturore ka për qëllim promovimin e vlerave kulturore të grupeve tnikë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë dhe jo rastësisht motoja e aktiviteteve të këtij viti ishte fuqia qëndron të diferenca dhe jot e

ngjashmëritë. Shoqata Multikultura është një organizatë joqeveritare që është themeluar në gusht të vitit 2000 e cila si qëllim ka aktivizimin e të rinjve si dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme kulturore.


Aksion për dhurimin e gjakut

Tetovë, 4 maj- Kryqi i kuq në Tetovë në bashkëpunim me komunën e Zhelinës ka organizuar aksion për dhurimin e gjakut në ambientet e kësaj komune. Puntorë të administratës i janë bashkangjitur këtij aksioni humanitar së bashku me puntorë të ndërmarrjeve të kësaj komune. Në ndërkohë, këtij aksioni i është bashkangjitur edhe vet kryetari i komunës së Zhelinës Blerim Sejdiu, i cili nënvizoi se i bashkangjitet aksioni sepse është ka të bëjë me aspektin humanitar. Përndryshe, organizata e kryqit të kuq në Tetovë vite vite me radhë organizon aksion të kësaj natyre për grumbullimin e sasisë së gjakut për nevojat e Spitalit.

Raporti i Prosperitetit të vitit 2017 vë në pah karakteristikat e munguara të Shqipërisë, që e bën atë të pozicionohet në vendin e 75 nga 149 shtete në botë, në një zonë të portokallinjtë, shumë pranë "të kuqes" alarmuese. Sipas nënkategorive të marra në studim, Shqipëria, e renditura e fundit në rajon, performon keq në situatën mjedisore dhe kapitalin njerëzor...

RAPORTI I PROSPERITETIT TË VITIT 2017

SHQIPËRIA E 75-A NË BOTË, E FUNDIT NË RAJON



Norvegjia rezulton shteti më me prosperitet për të nëntin vit radhazi, duke u pasur nga Zelanda e Re, Finlanda, kurse Zvicra ndodhet në vendin e katërt. Ky është viti i 11-të që Instituti Legatum, me bazë në Britani nxjerr raportin e Prosperitetit. Sipas tyre, ky studim përpiket që të tregojë rrugën nga varfëria drejt prosperitetit.

PO SHQIPËRIA?

Sipas rankimit ndër vite, vendi ynë ka bërë një rritje me një shkallë. Sipas kriterëve të vlerësimit, vendi ynë duket se performancën më të keqe e ka në nënkategorinë e mjedisit, e renditur e 125 në botë, e ndjekur më pas nga kapitali njerëzor e 119, si dhe ekonomia në tërësi, e 110-ta. Në qeverisje renditemi të 78-tët në botë; mundësitë e të bërit biznes të 71 në botë.

Për edukimin, jemi në vendin e 76, shëndeti në 45.

Në një krahasim me rajonin, Shqipëria ka renditje të ulët. Maqedonia rezulton shteti me performancën më të mirë, e 56-ta në botë, pas saj, vjen Serbia, me një renditje 58 nga 149 vende, plot 17 vende sipër Shqipërisë. Edhe Mali i Zi, i treti në Ballkan, renditet i 65, dukshëm më lart se sa vendi ynë.

PROSPERITETI GLOBAL NË NJË REKORD TË LARTË

Prosperiteti në botë u rrit në vitin 2017 dhe tani qëndron në nivelin më të lartë në dekadën e fundit. Sipas raportit, aktualisht është 2.6% më i lartë se në vitin 2007.

Për më tepër, rritja e prosperitetit ka qenë më e shpejtë nga 2012 në 2017 sesa që ishte nga viti 2007 deri në vitin 2012. Megjithatë, hendeku midis rezultateve më të larta dhe më të ulëta në Indeks është rritur për pesë vjet të njëpasnjëshme, duke treguar se ndërsa prosperiteti në tërësi mund të rritet, jo të gjitha vendet përfitojnë nga rritja.

PËRMIRËSIMI I LLOGARIDHËNIES SË QEVERISË

Çdo rajon në botë u përmirësua në Qeverisje në vitin 2017, me Azinë dhe Afrikën Sub-Sahariane që pati një rritje më të shpejtë. Në të gjithë botën, gjyqësori u bë më

i pavarur nga ndërhyrja e shtetit dhe procesi i sfidimit të rregullimit qeveritar u bë më i lehtë. Njerëzit gjithashtu u bënë më të sigurt në rezultatin e zgjedhjeve.

EVROPA PERËNDIMORE TEJKALON AMERIKËN E VERIUT

Për herë të parë në Indeks, prosperiteti i Europës Perëndimore është më i lartë se në Amerikën e Veriut. Prosperiteti i Evropës Perëndimore mbeti gjerësisht konstante; por Amerika e Veriut ra më shpejt se çdo rajon tjetër, për shkak të rritjes së numrit të vrasjeve dhe presionit më të madh shoqëror mbi lirinë e besimit të qytetarëve./ MONITOR



E planifikon 'bllokadë' buxhetore

Brukseli po propozon të rrisë tavanin maksimal të buxhetit të BE, duke krijuar një bllokadë për të mbrojtur klasifikimin e kreditit të AAA të unionit, ndërsa zgjeron kapacitetin e tij të kreditimit. Komisioni Europian dëshiron të japë fuqi të mjaftueshme shpenzimeve për buxhetin e BE-së, për t'i dhënë bllokut këshutë shumë hapësirë për të nënshkruar kredi të lira për vendet e eurozonës të goditura nga goditjet e ardhshme ekonomike, që nuk kërkojnë një paketë shpëtimi të plotë. Një propozim i komisionit i parë nga Financial Times argumenton se BE-ja ka nevojë për më shumë "hapësirë" në buxhetin e saj për të mbuluar "përdorimin në rritje" të instrumenteve financiare, duke përfshirë një "instrument stabilizimi për zonën e euros". Ky veprim është një përpjekje nga komisioni për të kënaqur thirrjet nga Emmanuel Macron, presidenti francez, për eurogrupin, për të mbështetur "sovrانيتin" e tij. Ky propozim vjen kur komisioni përgatitet të zbulojë një plan javën e ardhshme për buxhetin e BE-së 2021-2027, i cili do të kombinojë rritjen e shpenzimeve në fushat prioritare të reja, me shkurtime të programeve që mbështesin fermerët dhe zhvillimin ekonomik në rajonet më të varfra. Projekt propozimi nuk përcakton shifra të sakta. Por zyrtarët e BE kanë diskutuar ngritjen e të ashtuquajturit "tavan të burimeve të veta" – shuma maksimale e parave që bashkimi mund të rritë nga shtetet anëtare në një vit – nga 1.2 në 1.3 përqind të të ardhurave kombëtare bruto.

Turqi, rekord turistësh në tremujorin e parë të 2018-s

Instituti i Statistikave të Turqisë (TurkStat) publikoi të dhënat e turizmit për periudhën janar-mars të këtij viti. Sipas të dhënave në fjalë Turqia ka thyer rekordin e të gjitha kohërave duke mirëpritur në tremujorin e parë të vitit 5 milionë e 128 mijë e 406 vizitorë të huaj, ose 35% më shumë krahasuar me tremujorin e mëparshëm.



Kurse të ardhurat nga turizmi në këtë periudhë u rritën me 31,3% krahasuar me të njëjtën pe-

riudhë të vitit të mëparshëm dhe u realizuan në 4 miliardë e 425 milionë e 237 mijë dollarë.

Në të njëjtën periudhën (janar-mars 2018) erdhën në Turqi edhe 2 milionë turq që jetojnë ja-

shtë shtetit. Kështu numri total i vizitorëve që erdhën në Turqi në tremujorin e parë të 2018-s është 7 milionë banorë, kurse raporti i rritjes së numrit të vizitorëve i ka kaluar 50%.

Parashikohet që deri në fund të vitit (2018) numri i turistëve që do të vijnë në Turqi të jetë më i madh se 40 milionë, kurse të ardhurat nga turizmi nga 26,5 miliardë dollarë që ishin të vitin e kaluar të rriten në 32 miliardë dollarë./ TRT TURKEY

KOSOVË, MBI 3 MILIARDË EURO PËR AUTOSTRADA

Më shumë se dy miliardë euro janë shpenzuar deri më tash në vendin tonë për ndërtimin e autostradave që lidhin Prishtinën me Shqipërinë, Shkupin, Pejën, Mitrovicën dhe së fundi me Gjilanin. Hiç më pak se 1 miliardë euro të tjera pritet të shpenzohen për përfundimin e punëve në autostrada ekzistuese, por edhe nisjen në ndërtimin e autostradës së re prej 91 kilometrash, që do ta lidhë Istogun me Prizrenin, shkruan sot Gazeta "Zëri".

Ende pa përfunduar në tërësi punimet në ndërtimin e autostradës Prishtinë–Shkup, Qeveria e Kosovës tashmë ka nisur ndërtimin e autostradës së re, që lidh Prishtinën me Gjilanin.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kohore Qeveria ka iniciuar edhe hartimin e projektit për ndërtimin e autostradës së fundit, asaj që do ta lidhë Istogun e Prizrenin, e cila pritet ta ketë koston më të lartë se të të gjitha autostradave të tjera për shkak të gjatësi-



së, por edhe numrit të madhe të pronave që pritet të shpronësohen për realizimin e saj, shkruan më tutje "Zëri".

Duke u bazuar në të dhëna të Ministrisë së Infrastrukturës, vetëm për realizimin e autostradës që lidh Prishtinën me pikën kufita-

re më Morinën janë shpenzuar rreth 1 miliardë euro.

Po ashtu më shumë se 600 milionë euro do të shpenzohen për ndërtimin e autostradës Prishtinë–Shkup.

Qindra miliona euro para të buxhetit të shtetit, të donatorëve, por edhe të borxheve janë shpenzuar deri më tash për ndërtimin e dy autostradave, që punimet kanë nisur kohë më parë, asaj Prishtinë–Pejë, si dhe autostradës Prishtinë–Mitrovicë.

Një grua bëhet burrneshë duke u betuar me një betim të parevokueshëm, para dymbëdhjetë fshatrave ose pleqve fisnorë, për të praktikuar beqarinë. Më pas ajo lejohet të jetojë si një burrë dhe mund të vishet me rroba mashkulli, të përdorë emrin mashkullor, të mbajë armë, të tymosë, të pijë alkool, të marrë punën e meshkujve, të veprojë si kreu i një familje (për shembull, të jetojë me një motër ose nënë), të luajë muzikë dhe të këndojë, të ulet dhe të flasë shoqërisht me burra, shkruan albinfo.ch.

Ky është njëri ndër definicionet për fenomenin e Virgjërshave të Betuara – Burrneshave, e që si shfaqje teatrale pati premierën mbremë në "Schlachthaus Theater" të Bernës.

Me skenar të autorit dhe regjisorit kosovar, Jeton Neziraj, e me regji të Johannes Magger, në këtë shfaqje si kryepersonazhe vjen edhe aktorja shqiptare që jeton në Zvicër, Albana Agaj, e cila paraqitet në rolin e Burrneshës Sose.

Duke qenë se në vitin 2016 ka takuar dhe ka zhvilluar një intervistë me një burrneshë të vërtetë, Albana, gjatë prezantimit të projektit producentëve dhe disa nga protagonistëve të kësaj shfaqjeje, ata kanë qenë të habitur e mjaft mbesues me këtë fenomen, se si një femër vendos të bëhet mashkull vetëm për të trashëguar shtëpinë apo tokën e prindërve, në mungesë të meshkujve në shtëpi.

"Fascinuese dhe shumë ekzotike", i konsideron Burrneshat dhe aktin e tyre regjisorin i shfaqjes, Johannes Magger. Ai me këtë rast e cilëson si një rast shumë të rrallë,

DRAMA "BURRNESHA", FASCINON PUBLIKUN ZVICERAN NË BERNË

Me skenar të autorit dhe regjisorit kosovar, Jeton Neziraj, e me regji të Johannes Magger, në këtë shfaqje si kryepersonazhe vjen edhe aktorja shqiptare që jeton në Zvicër, Albana Agaj, e cila paraqitet në rolin e Burrneshës Sose

ku femrat nga të bërit një burrneshë heqin dorë nga individualiteti i tyre, thjesht të ndikuara nga rrethanat, të cilat i imponohen.

Ndërsa autori i shfaqjes, Jeton Neziraj, e kundërshton paksa atë qasjen ku Burrneshat cilësohen ende si ekzotike nga bota perëndimore, sepse sipas tij, ato shpeshherë janë quajtur me cinizëm si një fenomen i një bote të pacivilizuar e patriarkale. Pra eksploatimi i fenomenit të Burrneshave nga ana e studiuesve perëndimore më shumë iu ka shërbyer atyre se sa vetë Burrneshave, transmeton tutje albinfo.ch.

Ndërsa në një sallë të stërmbyshur, e me publik me shumicë zvicerane, tek shikuesit shfaqja zgjoi një interesim mjaft të madh, ku

nuk munguan reagimet e shumta e herë-herë edhe qeshjet nga situatat nganjëherë komike.

Me pak fjalë ky ishte subjekti i shfaqjes: Zonja Durham, një angleze blogiste me gjendje të mirë, ndodhet në një udhëtim eksplorues në Shqipëri, ku përpjetet të humtojë rolet e gjinive në sfondin e kushtëzimeve me bazë kulturore. Në këtë e sipër ajo takon një Burrneshë të re, e cila jeton në një fshat malor të Shqipërisë dhe në komunitetin e atjeshëm ushtron funksionin e një burri. Ndërkohë paraqitet Julian Wood, një burrë transvestit dhe regjisor ambicioz teatri. Ai është në kërkim të aktorëve të përshtatshëm të performancës së tij, me të cilën dëshiron të bëjë revolucion në skenat tea-

trore të Londrës. Ai është fascinuar nga ajo që ka parë në tekstet e zonjës Durham dhe dëshiron të angazhojë patjetër një burrneshë në shfaqjen e tij. Por ngjarja fatkeqësisht nuk rrjedh sipas skenarit të përgatitur nga ai...

Pos premierës, më 3,4,5 dhe 8 maj, po në "Schlachthaus Theater" do të shfaqen edhe reprizat e radhës së kësaj shfaqjeje. Për të vazhduar më pas në fundin e vitit dhe vitin tjetër me reprizat e tjera në Luzern, Winterthur dhe Zürich.

Me idenë dhe konceptin e Forever Production, Burrneshat – Sworn Virgin, është një bashkëpunim i kësaj të parës me "Schlachthaus Theater" Bern, "Theater Winkelwiese", Zürich, "Kleintheater", Luzern dhe "Kellertheater", Winterthur.



Anton Nikë Berisha, fitues i orës së madhe letrare "Muza e Agimit"

Në kuadër të manifestimit tradicional "Ditët e Agimit", sot është mbajtur ora e madhe letrare "Muza e Agimit" që i kushtohet heroit Agim Ramadani. Në të morën pjesë shkrimtarëve nga të gjithë trojet shqiptare nga Gjilani, Zhegra, Prishtina, Tirana, Vitia, Presheva, Tetova, Shkodra, Bujanoci, Presheva, Ferizaj, Kamënica etj, njofton kumtesa. Në mes tri poezive, që u dalluan, kësaj herë, juria e përbërë nga Agron Tufa, shkrimtar nga Tirana, Sarë Gjergjin nga Vitia dhe Selvete Abdullahu nga Zhegra, poezinë më të dalluar të kësaj orë letrare e zgjodhën atë të Anton Nikë Berishës.

Sabit Rrustemi që edhe bëri hapjen e orës letrare, ka thënë se pjesëmarrja e shumë shkrimtarëve nga të gjitha trojet shqiptare, këtë ditë e bënë të veçantë sepse i kushtohet një heroit të veçantë të Kosovës, që ishte pos një luftarak i shkathtë edhe një artist që artin e kishte në shpirt.

Anulohet dhënia e çmimit Nobel për Letërsinë

Akademia suedeze njoftoi sot shtyrjen e dhënies së çmimit Nobel për Letërsinë për vitin 2018, pas zbulimit të një skandali për ngacmime seksuale.



"Çmimi Nobel 2018 për Letërsinë do të jepet dhe njoftohet në të njëjtën kohë me fituesin e vitit 2019", njoftoi institucioni në një komunikatë.

Është hera e parë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore që ky çmim nuk jepet në kohën e duhur. /ATSH

Cosby dhe Polanski përjashtohen nga Akademia e Çmimeve Oskar

Akademia e Çmimeve prestigjioze Oskar njoftoi sot se do të përjashtojë yllin e televizionit Bill Cosby, i shpallur fajtor për abuzim seksual dhe regjisorin e famshëm Roman Polanski, i cili pranoi marrëdhënien e paligjshme seksuale me një minorene 13 vjeçe, dyzet vite më parë.

"Këshilli i drejtuesve të Akademisë së arteve dhe kinemasë u mbledhën të martën dhe votuan përja-



shtimin e aktorit Bill Cosby dhe regjisorit Roman Polanski nga radhët e tyre, në përputhje me normat e

etikës", bëhet e ditur në një deklaratë të Akademisë.

Këshilli vijon të promovojë normat e etikës, duke

iu drejtuar anëtarëve të tij për sjellje në përputhje me vlerat e dinjitetit njerëzor.

Ish-ylli i televizionit amerikan, Bill Cosby u shpall fajtor të enjten e kaluar për abuzim seksual në vitin 2004 me një ish-basketbolliste, Andrea Constand.

Ai rrezikon deri në 30 vite burg. Dhjetëra gra të tjera e kanë akuzuar për keqtrajtim për ngjarje që datojnë shpesh, rreth 30 vjet më parë. /ATSH

Përkatësia evropiane e trashëgimia kulturore shqiptare

Konkursi Colours of Albania 2018 çeli siparin në mjediset e Universitetit të Arteve nën moton "Trashëgimia kulturore dhe përkatësia evropiane".

Konkursi u çel në prani të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati, Ministres së Kulturës, Mirela Kumbaro, Ambasadores së Delegacionit të BE-së në Shqipëri Romana Vlahutin, trupit diplomatik të akredituar në Shqipëri dhe shumë të ftuarve të

tjerë nga fusha e artit dhe kulturës.

Edicioni i 4-rt i konkursit të fotografisë dixhitale #ColoursofAlbania2018, ka si moto "Trashëgimia kulturore dhe përkatësia evropiane", e cila përkon me lajtmotivin e Bashkimit Europian për vitin 2018.

Konkursi do të jetë i hapur deri më 30 korrik 2018 dhe do të përfshijë edhe temat mbi ngjyrat e shoqërisë shqiptare, bashkëjetesën fetare, qytetet e fshatrat mah-



nitëse, bregdetet e peizazhet e paprekura, si dhe transformimin e Shqipërisë në vitet e fundit dhe rindlindjen e zonave rurale.

Gjatë fjalës së tij me këtë rast, Ministri Bushati vuri në pah se "shpesh çështjet e politikave evropiane duhet t'i kanalizojmë drejt ba-

shkëpunimit kulturor. Kjo është arsyeja se përse këtë vit vendosëm që fokusin ta kishim tek trashëgimia kulturore, tek inputi dhe kontributi i Shqipërisë në mozaikun e familjes së madhe evropiane, me shpresën se do të nximisim sa më shumë imagjinatën e qytetarëve tanë por dhe të atyre që do ta vizitojnë Shqipërinë gjatë sezonit turistik për të fiksuar foto që e dëshmojnë më së miri këtë gjë". /ATSH

Bashkë ne luftë, pikë e pesë në paqe

Nga
Daut DAUTI



Edhe një përvjetor i luftës... Çdo vit, në rajonin e Likovës, apo në rrethinën e Tetovës apo Shkupit, ka data për t'u shënuar nga lufta 2001. Fillimi i aksioneve të para, Kalaja e Tetovës, shpallja zones së lire në Karadak, Luboteni, Gazi Baba..., Marrëveshja e Ohrit... Një dinamikë shënimesh, të cilat krijojnë aktivitete nga vendi në vend, nga data në datë. Kështu ishte edhe para disa ditësh, me rastin e 2 majit, ditës kur zona e Karadaku qe shpallur e lirë... Pjesëmarrësit në luftë, banorët, familjet e të rënëve, për këto vite, në shumë raste kanë kujtuar çastet që shënuan ato disa muaj rezistencë në rajonet e përfshira nga operacionet ushtarake. Mirëpo, shpesh kanë rënë në sy dukuri për të cilat duhet folur haptas.

Edhe kur shkruaja kolumna në një gazetë tjetër (Dnevnik), kur vinin këto data, i shprehja dilemat nëse janë të arsyeshme gjithë këto shënime dhe sidomos për mënyrën e shënimit të tyre. Kjo veçanërisht ka rënë në sy kur është shënuar përvjetori i Marrëveshjes së Ohrit, por nuk bëjnë përfshirje as datat tjera të 2001-shës, anise në kontekst paksa më të ndryshëm. Pse?

Vjen 13 gushti, dhe bëhet një "shënim shqiptar" i Marrëveshjes së Ohrit. Gjitha aktivitetet i organizon dhe realizon Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë, në krye të së cilit domosdo është një ministër shqiptar, pjesëmarrësit në ato aktivitete janë kryesisht shqiptarë dhe diplomatë të huaj, kurse pjesa maqedonase e pushtetit të shpeshtën qëndron anësh ose jep ndonjë deklaratë kurtoazie sa për të thënë diçka. Marrëveshja e Ohrit vërtetë e ndali luftën, por

ne nuk mund ta përvetësojmë si diçka për të cilën duhet të ngazëllemi... Kështu disi pat deklaruar njëri nga kryeministrat e kaluar. Me një fjalë, shënim i përvitshëm i kësaj date mbetet halë në sy për pjesën etnike maqedonase, duke përjetuar dhe trajtuar sot e kësaj dite si një marrëveshje "të imponuar me forcë", ndaj dhe ata që e kanë nënshkruar, i ikin me vetëdije pjesëmarrjes së tyre në këto shënime. Që t'iu iket këtyre situatave të pakëndshme, para disa vitesh pata hedhur idenë që përvjetorët e këtyre të shënohen jo çdo vit me aktivitete të përsëritura dhe pa invencë, por në përvjetorë të rrumbullakuar, në çdo pesë ose dhjetë vjet, me aktivitete më përmbajtësore.

Nëse Marrëveshja e Ohrit nuk mund t'i bëjë bashkë shqiptarë e maqedonas, ato datat tjera para të luftës, mund t'i bëjnë edhe më pak. Realisht, as që pritët të ndodhë ndonjë ndryshim radikal në qasjen e dy palëve etnike për karakterin dhe efektet e luftës. Sepse, përderisa njëra palë mendon se ajo luftë ishte e drejtë dhe e domosdoshme për shkak se kishin dështuar të gjitha përpjekjet politike për të avancuar statusin e shqiptarëve, pala tjetër e mendon të kundërtën, se lufta ishte e panevojshme dhe se ato të drejta do të arriheshin edhe pa luftë. Është e hapur mundësia që një ditë, kushedi kur, që taboret etnike t'i përfrojnë qëndrimet dhe me më shumë ngazëllim ta përkujtojnë marrëveshjen, për të cilën shqiptarët dhe shumë faktorë të tjerë, mendojnë se e shpëtoi Maqedoninë nga ndarja, por edhe se ajo nuk qe as përafërsisht e përgjakshme sa t'i çrregullojë marrëdhëniet ndëretnike përgjithnjë.

Por, edhe pse e mora si shembull të parë Marrëveshjen e Ohrit, sa për ilustrim, fjalën më tepër e kisha për përvjetorët tjerë të vitit 2001, sepse për to vlen edhe më shumë dilema e shprehur më sipër, vallë ka nevojë për manifestime përkujtimore çdo vit nga organizatat e veteranëve (që janë dy), nga BDI-ja, ku është bërthama e ish-UÇK-së, ose edhe të grupeve të ndara nga këto subjekte? Çështja nuk është e thjeshtë, sepse shpesh dominon dioptria e ndryshme ndaj ngjarjeve, por dhe një ngarkesë emotive për shkak të ndasive të sotme në skenën politike. Sikundër që për Marrëveshjen e Ohrit njëra palë më me dëshirë do të kishte zgjedhur heshtjen ose injorimin, edhe në rastin e këtyre datave tjera brenda vetë shqiptarëve paraqiten animozitetet që kanë lindur pas luftimeve dhe ka bojkot të këtij ose atij subjekti me arsyetim përse ky e jo ai subjekt të jetë bartës aktivitetesh, kush të flasë i pari e kush më pas, kush ka më tepër e më pak merita... Për shkak të këtyre ndasive të cilat u bënë paksa edhe nga "pluralizimi" i vetë UÇK-së, kur për arsye të ndryshme, ish-pjesëtarë dhe udhëheqës të tyre u inkuadruan në subjekte të ndryshme politike, kundërshtitë e ndërsjella të tashme i përçojnë gjer në vitin e luftës kur këso ndasish nuk ka pasur mes tyre. Mu për këtë, ka pasur disa shënime të zbehta përvjetorësh, pasi duket sikur aktivitetet me shumë fjalime çdo vit e kishin humbur kuptimin. Nëse e shikojmë edhe sivjet se çështje shkruar e deklaruar nëpër portale dhe rrjete sociale, do të fitojmë bindjen se në luftën e 2001-shës ka pasur më shumë ushtri çlirimtare, më shumë shtabë, më shumë shefa shtabesh kryesore, më shumë përfaqësues

- Nëse e shikojmë edhe sivjet se çështje shkruar e deklaruar nëpër portale dhe rrjete sociale, do të fitojmë bindjen se në luftën e 2001-shës ka pasur më shumë ushtri çlirimtare, më shumë shtabë, më shumë shefa shtabesh kryesore, më shumë përfaqësues politikë!... Ngjarjet që sollën ndryshime në statusin e shqiptarëve nuk duhet të harrohen, por as të devalvohen me shënime të improvizuara. Ato do të ishin më përmajtësore nëse do të mbaheshin çdo pesë ose dhjetë vjet, pra, në përvjetorë të rrumbullakësuar dhe të shërbejnë për më shumë unitet, e jo për ndasi politike.



politikë! Dhe së këndejmi, sikush ka preferuar t'i bie telit që sot mendon se është e vërteta. Kësisoj, bie fjala, një veprimtar i cili ka qenë në ato lëvizjet që sollën kryengritjet në Kosovë, Maqedoni e në luginën e Preshevës, i cili vetë nuk ka qenë i kyçur drejtpërdrejt por gjithnjë kërcënohej pas luftës me një ushtri tjetër, i jep lirinë vetes që të devalvojë luftën me teza që i kanë plasuar me vite disa qarqe maqedonase se gjoja lufta e 2001-shës është e kurdisur midis Branko Cërvenkovski dhe Ali Ahmeti! Janë të kuptueshme qëndrimet dhe interesat e ndryshme në kohë pluralizmi politik, por mohimi i idealeve për të cilat dje ishin bashkë, është fare i pakuptueshëm dhe me prapavijë të dyshimtë.

Sa më larg ngjarjeve jemi, aq më shumë do të shtohen qasjet e ndryshme, ku objektivja dhe subjektivja do të ndërhyjnë në njëra tjetrën. Ngjarjet që sollën ndryshime në statusin e shqiptarëve nuk duhet të harrohen, por as të devalvohen me shënime të improvizuara. Ideja që manifestimet të bëhen në përvjetorë të rrumbullakësuar, duhet të merret me seriozitet dhe atë ta shqyrtojnë organizatat e veteranëve dhe banorët ku janë zhvilluar këto ngjarje, sepse ato duhet të jenë përmbajtësore dhe të shërbejnë për më shumë unitet, e jo për ndasi politike. Pra, manifestime të racionalizuara në maksimum çdo pesë (ose dhjetë) vjet, mundësisht me një manifestim qëndror, ndërkaq çdo vjet kurora te varrezat e dëshmorëve, pa fjalime e masivitet, do të ishte një masë e duhur respekti dhe përkushtimi.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Neuronet e frikës



Nga
Arben TARAVARI

Frrika! Kjo ndjenjë aspak e këndshme na shoqëron gjithë jetën. Gjatë gjithë historisë të njerëzimit Frika ka qënë frenuese e shumë zhvillimeve shoqërore dhe është një armë e jashtëzakonshme për të gjithë ata që duan të ndalojnë një gjest të caktuar apo edhe një popull të tërë të jetojë ashtu si nga ana tjetër ka qënë promotor që ka arritur të eliminojë shumë armiq të cilës do natyrë.

Frika në kulturën shqiptare kryesisht është shenjë burracakërie dhe vogëlsie, pavarësisht se po nga të vjetrit tanë ka dalë proverba: frika ruan vreshtin! E mençur si thënie sepse duke e lidhur me profesionin tim të neurologut bën sens shkencor, pasi një njeri që s'ka frikë domethënë që Truri ka anomalji funksionale, që nuk percepton ndaj nuk reagon! Mirëpo nga ana tjetër çfarë është ajo që shkakton frikë? Le të ndalojmë në këtë fenomen emocional që është i lidhur ngushtë me amigdalën në tru, në fakt frika lind nga truri. Frika është një përgjigje emocionale që prodhon truri, në momentin që percepton gjendje rreziku! Çdo kërcënim që kuptohet si i tillë sjell një ndjenjë të lartë shqetësimi e cila dëmton cilësinë e jetës të individit që pëson, pra që ka frikë. Por është pikërisht po e njëjta ndjenjë që tek individë të tjerë ndez kurajon si përgjigje, dmth që

Çlirohuni nga prangat e frikës dhe mos e lini vetëm një punëtor të papunë kur ngre zërin, një prind kur proteston për shkollën, një profesor të pushuar nga puna padrejtësisht, një viktimë të drejtësisë, një votues të dënuar pse nuk ka votuar në mënyrë të detyruar...

ka shumë individë të cilët kanë një prag frike që pasi e kalojnë atëherë janë të lirë për të vepruar jashtë presionit të saj.

Në rajonin cerebral të Amigdalës gjenden disa neurone që cilët janë kujdestarët e frikës, quhen Qeliza të Tipit I dhe janë këto le t'i quajmë ministra të frikës.

Ajo që shkencërisht më bën kurioz është Pragu i Frikës. Është i ndryshëm tek çdo individ, ashtu si është i ndryshëm dhe lloji i karburantit që do motori i frikës për tu ndezur. Por në momentin ku kemi të bëjmë me kushte sociale të përbashkëta, me njerëz që kanë frikë nga i njëjti fenomen, si mund të vepohet që këta individë të shpëtojnë nga ndjenja më e pakëndshme pas vetmisë, që është pikërisht Frika?!

Thonë që armët e vetme të Djallit janë Frika dhe Dyshimi, e bëra këtë aneks religjioz për të forcuar ende më shumë idenë se sa e papëlqyeshme është ndjenja e frikës! Por si mund të shpëtojmë prej saj?! Një nga format më të shpeshta që Truri e zhvillon frikën është si pasojë e kanosjes objektive, pra një kërcënim konkret (sëmundje, vetmi, varfëri, denigrim). Por a mund të merret autonomia e Amigdalës? A mund të rrisim kontrollin në neuronet që shkaktojnë frikën dhe që janë jashtë diktatit të Ndërgjegjes tonë?

A mund të ketë një prag frike që na përkufizon të gjithëve?! Pasi mendoj që nëse frika është e përbashkët, si në rastin tonë p.sh që vjen nga keqmenaxhimi i pushtetit, nga varfëria, nga mungesa e mundësive, nga kërcënimet e ardhmes të fëmijëve, atëherë edhe reagimi duhet të jetë i përbashkët! Që kemi frikë është kuptuar tash e disa vjet, dhe tek e fundit është krejt normale të kesh frikë para faktorëve të tillë të riskut, por nuk është normale që të vazhdojmë të bashkëtojmë me Qelizat e Tipit I të cilat në trurin tonë duket se kanë ardhur në pushtet dhe ushtrojnë regjimin e tyre prej një kohe kaq të gjatë.

Ndjenja e tmerrshme e Frikës duhet të arrijë pragun e saj. Nëse jo të gjithë mund të mbysin frikën ndaj sistemit, atëherë shikoni ato burra e gra, vajza e djem të cilët po ikin. Nuk ju mjafton braktisja masive që po i ndodh vendit për të kuptuar që është koha të largohemi nga qarku i Frikës?!

Nëse analizojmë me gjakftohtësi elementet që na intimidojnë janë të gjithë të arsyeshem, pra është normale që përballë kësaj strukture të kesh frikë, por ende më shumë normale është të heqësh dorë nga frika. Duke pësuar shqetësimin e humbjes të lumturisë ne nuk kemi bërë asgjë tjetër veçse e kemi humbur këtë lumturi! Kjo vërtetohet

përditë me numrin progresiv të atyre që dorëzojnë çelësat e vendlindjes duke ikur. Domethënë që të paralizuar nga neuronet e Frikës ne nuk po shkojmë dikundi përveçse në izolim të personalitetit dhe në vetshkatërrim. Lajmi i mirë është që po të njëjtët faktorë që na mbajnë të ndrydhur mund t'i përdorim për të gjetur lirinë personale që përkthehet në mirëqenie shoqërore. Mendojeni trurin tuaj si një muskul që ka nevojë për stërvitje. Filloni të autosugjestiononi neuronet tuaja, qoftë edhe Qelizat e Tipit I që shkaktojnë frikën tek ne dhe do të kuptoni se si pas pak kohe do të fillojnë t'ju përgjigjen. Mos e lini ndërgjegjen tuaj të thërrasë vetëm brenda, ngreni zërin. Çlirohuni nga prangat e frikës dhe mos e lini vetëm një punëtor të papunë kur ngre zërin, një prind kur proteston për shkollën, një profesor të pushuar nga puna padrejtësisht, një viktimë të drejtësisë, një votues të dënuar pse nuk ka votuar në mënyrë të detyruar. Nëse bëheni të gjithë bashkë, truri juaj do ta ketë më të lehtë stërvitjen drejt vullnetit të lirë, drejt qytetëritimit i cili është i yni, është në trurin tonë, në mikun tim që i ka brenda të gjitha misteret por dhe të gjitha përgjigjet.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Letër skllavopronarit tim të vjetër

Në 1864, pas 32 vitesh të gjata shërbimi për skllavopronarin e tij, Jourdon Anderson dhe gruaja e tij, Amanda, u arratisën nga jeta e skllavit, ku kishin punuar në mënyrë të palodhur. Ata u kapën fort pas mundësisë që iu dha ushtria e Shteteve të Bashkuara, kur i lironi nga puna e detyruar në plantacione dhe shpejt e shpejt u zhvendosën në Ohajo. Jourdon gjeti një punë të paguar në të cilën mbështetej familja e tij, që rritej çdo ditë e më shumë. Ai s'e ktheu kurrë më kokën pas. Një vit më vonë, pak pas përfundimit të Luftës Civile, ai mori një letër nga Patrik Henri Ander-

son, burri që dikur e kishte nën pronësi, në të cilën ai i lutej të kthehej e të shpëtonte biznesin e tij, që po shkatërrohej.

Përgjigja që Jourdon i ktheu njeriut që i skllavëroi familjen, është ribotuar disa herë në gazeta të ndryshme. Jourdon Anderson nuk u kthye më kurrë në Big Spring, Tennessee. Ai vdiq në 1907, në moshën 81 vjeçare, dhe është varrosur afër gruas së tij e cila vdiq 6 vjet më vonë. Ata patën bashkë 11 fëmijë.

"DAYTON, OHIO,
7 CUSHT, 1865,
Zotëri: E mora letrën tuaj dhe më bëhet qejfi që ju nuk e keni harruar

Jourdonin, e që dëshironi që unë të kthehem për të jetuar përsëri me ju. Kam qenë në merak për ju. Ma merrte mendja se do t'ju kishin varur deri tani, meqë keni strehuar ushtarë të konfederatës gjatë luftës civile. Edhe pse ju keni shtënë me armë dy herë mbi mua para se të ikja, nuk do të doja të dëgjoja asnjë lajm të keq për ju, dhe më vjen mirë që jeni akoma gjallë. Mua do të më bënte mirë të kthehesha në shtëpinë e vjetër dhe të takoja gjithë njerëzit që lashë pas. Përsëritet ata nga ana ime dhe thua ju se shpresoj t'i takoj sërish në një botë më të mirë, nëse jo në këtë të tashmen. Do të kaloja të të

Përgjigja që Jourdon i ktheu njeriut që i skllavëroi familjen, është ribotuar disa herë në gazeta të ndryshme. Jourdon Anderson nuk u kthye më kurrë në Big Spring, Tennessee. Ai vdiq në 1907, në moshën 81 vjeçare, dhe është varrosur afër gruas së tij e cila vdiq 6 vjet më vonë. Ata patën bashkë 11 fëmijë

takoja gjatë kohës kur punoja në spitalin e Nashvillit, por njëri nga fqinjët më tha se ishte betuar të më vrisje, në rastin e parë që do të të jepej mundësia.

Dua të di se cila është oferta më e mirë që mund të më bësh. Fitoj 25 dollarë në muaj, ushqime dhe veshje. Kam një shtëpi të rehatshme për Mendin dhe fëmijët. Fqinjët e quajnë atë zonja Anderson. Fëmijët shkollohen mirë dhe mësuesja thotë se djali ka prirje për pastor. Frekuentojmë kishën rregullisht dhe trajtohem përgjithësisht mirë. Ndonjëherë dëgjojmë njerëz të thonë: 'Ata negrot atje kanë qenë skllavë në Tennesi'. Fëmijët ndihen keq nga këto cilësime, por unë u them se atje nuk ishte turp t'i përkisje kolonel Henrit. Përkundrazi, ishte një nder për ne, t'ju thërrisim pronar. Tani, nëse do të më shkruani dhe të tregoni se cilat janë përfitimet e mia nga ti, atëherë do ta kem shumë më të thjeshtë të vendos nëse dua të kthehem apo jo.

Përsëritet George Carter-in nga unë dhe falënderojë që të hoqi pistoletën nga dora, kur u përpoqe të më vrasësh.

Nga shërbëtori yt i vjetër, Jourdon Anderson".



shtojcë enigmatike e fundjavës

FJALËKRYQI KLASIK



HORIZONTALISHT

3. Armë e rëndë zjarri
5. Përfundim në shah
7. Një e katërta
9. Ai që shan, sharës
10. Hapja e këmbës gjatë të ecjes (sh.)
12. Pantallona prej shajaku për burra
13. I pamartuar
15. Furça
16. Tatimi
18. Shkronjë greke
20. Lloj vepre letrare
23. Shok, jaran
26. Fshat afër Kavadarit
28. Burrë trim e bujar
29. Trajneri turk, Koxhaman
30. Drejtim, kahje
31. Kënaqësia, dëshira
33. Shpërbërj, copëtimi (sh.)
41. Përkund
42. Njeri që zotëron njohuri e dije të thella
43. Shkronjë arabe
45. Internazionale
47. Ceremoni, ritual
48. Patinazhistja Koreane, Kim
49. Sport filipinez, art marcial

VERTIKALISHT

1. Mal në mes të Shqipërisë dhe Maq.
2. Anija e vogël, varka
3. Ana e mprehtë e një vegle
4. Futbollisti portuguez
5. Pjesë muzikore ushtarake
8. Në këtë sasi
9. Një e reshur (shq.)
11. Tatuazh
12. Presidenti Amerikan, Donald
14. Radiumi
15. Element kimik (Br)
17. Bejzbollist amerikan i Atlanta Brejvsit
18. Kade druri, tinar
19. Ujëra të ngrirë
21. Operë e Xhuzepe Verdit
22. Tenisti frëng, Janik (në original)
23. MegaBajt
24. Titull fisnik anglez, Kont
25. Nikeli
30. Banor i qytetit indian, Karera
32. Shkronja e 14-të dhe e 10-të
33. Humbje në mjete
34. Skuadër
35. Rritje apo zvogëlim i fotografisë
36. Indiumi
37. Iridiumi
38. Ndarës dhomash
39. Këngëtarja frënge, Pjaf
40. Emri i Lukrecit
45. Fija që lidh trurin me një organ
46. Futbollisti ynë, Bardhi.

Kakuro

e lehtë

		22	16		22	4
	9			8		
	3			3		
27						
6			4			17
			16			
	8			11		
	16			4		
34						
12			4			

mesatare

			4	3		
		4				
	7	29			11	
19						
	6			5		7
	9			3		
			17	3		
		25				
			10			


e vështirë

					17	3
				10		
	4	30	11			
	26					
	10					16
			16			
	3	17				
29						
10						




VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!



FSHEHËSIRA


Figurat e dhëna fshihen diku në fotografi. Ku?



FIGERMA (lexoni me objekte)

Kafshët!

Figurat gjeometrike përfaqësojnë shkronja. Zëvendësoni ato dhe do të gjeni pesë kafshë!




Figurat paraqesin shkronja, varësisht nga forma e tyre. P.sh. te rrratët do t'i shënoni zanoret.

- a, e, o, u, y
- ë, i
- c, ç, m, n, r, s, v, x, z
- rr
- b, d, f, h, k, l, t
- dh, ll, sh, th, xh, zh
- gj, nj
- g, j, p, q

Ndihmë: Zgjidhjet janë rradhitur sipas alfabetit Janë përdorur 18 shkronja, prej të cilëve 5 zanore.

DALLIMET

Cilët janë 7 dallimet në fotografitë e mëposhtme!



MINI INTEGRAMI | Grupi muzikor



Katër djelmosha nga qytete të ndryshme i lanë punët e tyre dhe vendosën të formojnë një grup muzikor. Në tabelë shënoni moshën, qytetin dhe punën paraprake të secilit prej tyre, duke u bazuar në të dhënat e mëposhtme.

1. Agroni është për dy vjet ose më i madh ose më i vogël se djaloshi nga Struga, i cili më parë ka punuar si kamerier.
2. Artar ka qenë ose Dritani ose çuni nga Kumanova (i cili "ndoshta" quhet Petrit)!?

3. Shkupjani është më i ri se Andi, por më i madh se ai që ka punuar si këpuctar.
4. 22- vjeçari nga Tetova nuk ka punuar si kamerier.

EMRI	PUNA	QYTETI	MOSHA

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".

KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.

ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!

MOSBARAZIMI

Plotësoni tabelën duke u bazuar në operacionin e mosbarazimit. Përdoren numrat prej 1 deri 5.

NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.

KRIPTOGRAMI

Kriptogrami zgjidhet sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë". Në fushat e hijëzuara shënoni emrin dhe mbiemrin e modeles shqiptare në foto, Armina.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
A	R	M	I	N									
15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	

NUMËRKRYQI

Horizontalisht:

1. ABC-ja e numrave
3. **3 vertikal**, pa një
5. E kundërta e **1 horiz**.
6. Zvogëlohen për 3
8. Shuma e **1 horiz** dhe **2 vertikal**.
10. Numra me radhë
12. Sanduic me 6
14. **7 vertikal**, ndarë me 3
15. Numri i parë është ndryshimi i dy të tjerëve
16. Anagram i **12 vertikal**.

Vertikalisht:

1. Rriten duke u shumëzuar për 3
2. Numra të njëjtë
3. Numri i sureve të Kuranit
4. **2 vertikal**, plus 3
7. Numri i djallit
9. Numri i tretë është shuma e dy të parëve
10. Hiqe **8 horiz**, nga **6 horiz**.
11. Shuma e **1 vertikal** dhe **10 horiz**.
12. **11 vertikal**, pa 1
13. Shuma e **4 vertikal** dhe **8 horiz**.

BARASPESHA

Plotësoni fushat e zbrazëta me numrat pozitivë dhe negativë prej 1 - 16, ashtu që shuma e numrave majtas dhe djathtas të jetë zero.

Që ta keni më lehtë, shfrytëzoni tabelën e dhënë. Nxini numrat që do t'i bartni.

MOZAIKU

2 shkronja: EL, EZ, IN, KA, OL, PN

3 shkronja: ANA, ANN, AEN, AOL, APA, ARI, BAK, IMI, IVA, KUR, MEU, MUM, SIT, SOD, UTA

4 shkronja: AKSI, ALLÇI, ALLMA, DARA, IKSI, INKË, KURIR, LINK, NARE, SOJA, TETA, TUND

5 shkronja: AKALA, AMERI, ANUAL, AROMË, ATAKU, ERMAL, ÈMBLA, IMERI, KOÇAN, KUART, NUNAT, NUNEZ, PISTA, SKAMA, SPORT, UNION

6 shkronja: ADAMOV, PUNIMI, SHAMATA, URIMET

7 shkronja: ADEKUAT, AMON RAA, ASAMATI, MARIFET, PANDORA, TARAFET, TREMBJA

8 shkronja: INTERNAT, TEOREMAT

12 shkronja: ANTIITALIANI, FALSIFIKIMET, FUTBOLLDASHËSI, MERITA HALILI.

Koha, e shtunë 17 mars, 2018

Sudoku

i lehtë

7	3			1			4	6
	8	1	4			3	7	
				6				
	5			9				
	2	6				1	9	
			6				8	
				7				
	6	3	8			9	2	
1	7			4			3	8

mesatar

	7				2	8		
5			7		1			
		3						
				7				
	9		2			1		
	5	8		6		4		
		4						
3	1	9		5	4			7
	8			1		3		

i vështirë

		8		3				
	4							3
			5					7
			2		1	7	9	
			1					
4			6					
2			7			4		
8	1		2					
	9	6		4				1

SKANDI I KOMBINUAR

Pjesën e hijezuar të fjalëkryqit plotësojeni sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë". Me shkronjat e tabelës do të fitoni zgjidhjet e rebusit dhe të anagramit.


Tabela

1	2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15	16

Anagrami

9	1	6	7	8	10	11	15	16	12	13	2	5	4	3	14
---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	---	---	---	---	----

Rebusi



MENSUR MAMUTI	QË SHPREH MELANKOLI	SHKRONJË GREKE	AKTORI AMERIKAN, UOREN	JO I SHËNDOSHË	QYTET NË TEKSAS, SHBA	IRIDIUMI	SOFTUER PËR KOMPRIM TË DOKUMENTEVE	ITALI	ÇMENDURI	KOHA E LIRË	HUMBJA NË MUJTE	VENDI I MAGJSTARIT TË HAROLD ARLENT
GATISHMËRI NË RAST RREZIKU										NOTË MUZIKORE TRUP I VOGËL QIELLOR		
I DËRGUARI								AFSHI I TOKËS SE LERUAR QË ËSHTË MIDIS DY SENDEVE				
PRODHIM I DRURIT						ANOHEM, KTHEHEM TË PASIONJARA PAS NJË KLUBI						TRASH, NGJIZ
ZBARDHJET E DITËS						1						
NATRIUMI			KLUB ITALIAN I FUTBOLLIT PORTUGALIA		2	3	4	5			FOSFORI FAN STELIAN	
KELVINI		MJESHTËRIA, ZANATI SHTET NË AZINË JUGORE		6	7	8	5	9	3			
OPUS				10		7	2	10		6		
LAPONEZ				11		12	13	5	14	3		
INSTITUCION QENDROR I ADMINISTRATËS												
D				9	1	5	6		15			KËNGËTARJA JONË, ENEDA
CELËS (ANG)			GJASHTARË, REVOLE TËRËSIA E ZAKONEVE		12	1	16	12			TEMPERATURA SHANK	
KOHA E LIRË	REZULTATI (HUAJ) CEP, KEND						12			RESERVE BANK OF AUSTRALIA KALIUMI		
YLL (ANG.)												
STADIUMI I RIEKES												KËNGËTARJA ANGLEZE, LENOKS AMERICIUMI
SPORTIST ME KANU												
K										ANAE NJERËZVE TË NJË RUPI (VJET) LUKSEMBURGU		
NJËSI KINEZE E GJATESISË												
												DISKUTIMI, DEBATI

SUDOKU

NONOGRAMI

MOSBARAZIMI

ARUKONE

KENKEN

SUDOKU " > "

NUMËRRYORI

DALIMET

VIZATIMI

KAKURO

REBUSI

FSHEHËSIRA

MINI INTEGRAMI I Grupi muzikor

SKANDI I KOMBINUAR

Presidenti i Austrisë: Serbia në BE, vetëm kur ta njoh Kosovën

Për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, Serbia duhet të zgjidhë konfliktin historik dhe çështjet e hapura të kufirit me Kosovën. Kështu ka thënë presidenti i Austrisë Van der Bellen pas takimit që ka pasur me homologun e tij bulgar, Ruman Radev në Sofje. Të dy presidentët, siç transmeton rtk, thanë se perspektiva evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor është e sigurt, por fillimisht mes këtyre vendeve duhet të vendosen raporte të mira fqinjësore, miqësore dhe të bashkëpunimit.



Gruaja e Ivanoviqit jep dëshmi për vrasjen e bashkëshortit

Pas disa anëtarë të partisë së Iniciativës Qytetare, tani do të jap dëshmi në Zyrën e Prokurorit Special edhe gruaja e Oliver Ivanoviqit, Milena. Tani kur janë bërë më shumë se 100 ditë nga vrasja e Ivanoviqit më 16 janar para selisë së partisë së tij në Veri të Mitrovicës, Milena ka thënë se ky rast është neglizhuar, shkruajnë mediat serbe. Ajo ka thënë për "News" se është bërë periudhë e gjatë pothuajse katër muaj që kur po i thonë se vetëm po vazhdojnë hetimet. "Ajo që është e frikshme është se kemi përvojë me disa raste të mëhershme. Sa më shumë kalon koha, aq më vështirë është të gjendet fajtori. Unë po u kërkoj prokurorëve që mos të vonohen dhe ta marrin më seriozisht këtë temë. Kjo punë po zvarritet ose për të fshehur dicka ose për të harruar gjithçka", ka thënë Milena Ivanoviq. Ajo ka theksuar se qëllimi i vetëm i saj është të gjendet autori dhe të marr dënimin e merituar të këtij krimi të tmerrshëm, duke shtuar se nuk do të heq dorë asnjëherë nga gjetja e fajtorit. E pyetur se pse e la Mitrovicën dhe u zhvendos në Beograd, ajo ka dhënë arsyetim vrasjen e burrit. "Mitrovica më mori gjënë që e desha më së shumti dhe prandaj vendosa që ta lë këtë qytet përgjithmonë", ka thënë tutje Milena.

DEPUTETËT E PAPËRGGJEGJSHËM TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Fillimi i seancave, e gjen zakonisht Kuvendin e Kosovës plot me deputetë në sallë, të gatshëm të debatojnë dhe të ngrenë çështje nga më të ndryshmet. Por, pjesa e punës pasdite në institucionin më të lartë ligjvënës të Kosovës shpesh është karakterizuar me mungesën e deputetëve, çka ka rezultuar me mungesë kuorumi dhe mungesë në vendimmarrje. Madje, vendimmarrja ka munguar edhe kur janë ngritur çështje të rëndësishme apo edhe aq të ndjeshme, siç rasti për rezolutën e propozuar për çështjen e personave të pagjetur në kohën kur ishte mbajtur seanca.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Elmi Reçica, nga Partia Demokratike e Kosovës, thotë se mospjesëmarrja e deputetëve në seancë apo ikja nga seanca është një papërgjegjësi e madhe e ligjvënësve. Sipas tij, deputetët e Kuvendit, janë duke bërë aktualisht punën më minimale të mundshme. "Mungesa e tyre, kur debatohet për çështje, pavarësisht se çfarë janë, por edhe kur është diskutuar për çështje me rëndësi, në fillim të seancës vijnë të gjithë deputetët, debatohet me orë të tëra siç ishte edhe dita e të zhdukurve dhe në fund nuk kemi kuorum votues. Në radhë të parë është papërgjegjësi e deputetëve dhe është edhe papërgjegjësi e vetë Qeverisë mungesa e ministrave në seanca plenare", thotë Reçica.

Kuvendi i Kosovës, sipas deputetëve, ka provuar t'i ndëshkojë deputetët me disa masa administrative, por ato nuk kanë dhënë



rezultate. Edhe deputetja Mimoza Kusari – Lila nga Alternativa, parti e cila është pjesë e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, thotë për Radion Evropa e Lirë se, mosprezenca e deputetëve në seanca ose ikja nga to, nis nga partitë politike [listat e kandidatëve për deputetë] e deri të papërgjegjësia e vetë deputetit. Kusari – Lila thekson se një numër i konsiderueshëm i deputetëve nuk e merr me seriozitet pozitën që ka si deputet i zgjedhur nga qytetari.

"Rregullat dhe procedurat duhet të kenë një modifikim, këtu duke përfshirë faktin se duhet të ketë edhe sanksione për deputetët që nuk marrin pjesë në seanca. Deputetët duhet të verifikohen në fillim dhe në fund të seancave, e po ashtu edhe në proces të votimit. Kur të ekzistojë një përcjellje e saktë e statistikave dhe pjesëmarrjes, atëherë mund të flasim

për deputetë, të cilët kontribuojnë në demokraci dhe në përgatitjen e legjislacionit dhe cilët janë ata që nuk e marrin me përgjegjësi këtë detyrë", shprehet ajo. Kusari -Lila thotë se duhet patjetër që të ekzistojnë sanksione në raste të mosvotimit të raporteve të agjencive, në rast të çështjeve të ndryshme në ekzekutiv.

"Kur të ketë një efekt të tillë të mirëfilltë në kuadër të strukturës të institucionet e tjera që i raportojnë Kuvendit, atëherë besoj se deputetët do ta marrin më me seriozitet pozitën e tyre", shtoi Kusari-Lila. Legjislatura e gjashtë e Kuvendit të Kosovës po përballet në vazhdimësi me mungesë të kuorumit, mirëpo kjo problematikë është më e theksuar muajve të fundit. Sipas Institutit Demokratik të Kosovës, për periudhën janar – mars, tetë seanca sa ka mbajtur Kuvendi, që të gjitha janë shtyrë për mungesë kuorumi. Këto seanca

ca janë përcjellë me vazhdime, madje, deri në katër herë.

"Ndonëse në listat e pjesëmarrjes të seancave të mbajtura për këtë periudhë kohore, janë nënshkruar 90% e deputetëve, një numër i konsiderueshëm i tyre nuk kanë qëndruar në sallë deri në përfundim të seancës. Për rrjedhojë votimi i pikave të rendit të ditës në ditën kur është paraparë, ka qenë i pamundur për shkak të mosprezencës së deputetëve", thuhet në një monitorim që e ka bërë KDI-ja.

Albert Krasniqi, nga Instituti Demokratik i Kosovës, që monitoron punën e Kuvendit, thotë për Radion Evropa e Lirë, se deputetëve duhet t'u vijë keq që nënshkruhen sa për mëditje dhe ikin nga seancat. "Kjo, vërtet, është shqetësuese për shkak se deputetët nuk po janë në krye të detyrës së tyre. Nuk janë në Kuvend për t'i përfaqësuar qytetarët, të cilëve u kanë kërkuar votën me qëllim të përfaqësimit në Kuvend. Kjo po e paralizon dhe dëmton punën e Kuvendit dhe funksionimin e këtij institucioni", vlerëson Krasniqi.

Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, parasheh dënime për deputetët vetëm në rast të mungesës në Kuvend për më shumë se gjashtë muaj, por nuk specifikon ndëshkime tjera për numrin e madh të mungesave. Ndryshe, Rregullorja e re e punës së Kuvendit është në procedurë të shqyrtimit për ndryshim. Kjo legjislaturë deri tash ka miratuar 22 nga 122 sa janë gjithsej. Në procedurë janë 31, kurse në pritje për shqyrtim 69 ligje. (REL)

Tetë shtete pjesë e ushtrimit fushor "Shqiponja 6"



Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) përmes një konference për media ka shpalosur detaje nga ushtrimi fushor "Shqiponja 6". Naim Haziri, gjeneral brigade dhe

drejtor i këtij ushtrimi ka thënë se ky ushtrim ka qenë i planifikuar që nga shkurti i vitit 2017. Ai shtoi se është fat që krahas tyre prezent janë edhe shtetet partnere, duke shtuar se qëllimi është që të vlerësohen kapacitetet reaguese të tyre. Haziri tha se FSK-ja është bartëse e këtij ushtrimi derisa të gjitha agjencionet e tjera të Kosovës do t'i kryejnë detyrat që kanë. Ai po ashtu deklaroi se në këtë ushtrim fushor do të marrin pjesë tetë shtete të cilat do të testojnë ndërveprueshmërinë mes vete. Ushtrimi do të bëhet në Komunën e Prishtinës, Obiliqit, Podujevës dhe Novobërdës. Shpend Tërdeva nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës, tha se ky ushtrim është një rast i mirë për demonstrimin e aftësive të tyre. Sipas një kumtese të dërguar nga Ministria e FSK-së, ushtrimi fushor "Shqiponja 6" do të realizohet nga data 04-12 maj.

HOXHA: Tahiri po foli, qeveria do të rrëzohet



Gazetari Artan Hoxha deklaroi në emisionin "Opinion" se Saimir Tahiri përbën një rrezik për mazhorancën nëse vendos të flasë. Hoxha u shpreh në studion e emisionit "Opinion", se nëse Tahiri do të flasë, mazhoranca bie. Ai tha se ditën e sotme Saimir Tahiri u dërgoi mesazh disa emrave të mazhorancës, duke nënkuptuar një kërcënim të hapur. Gazetari theksoi se Tahiri përbën një kërcënim për mazhorancën. "Nga ky moment Tahiri është një person i apasionuar pas aventurave dhe që del shëtitje vetëm nga Mali me Gropa. Ai duhet të bëjë kujdes që nga dita e sotme, ai duhet të tregohet i kujdesshëm edhe për jetën që bën. Sepse përbën rrezik për mazhorancën. Po foli Tahiri rrëzohet qeveria", deklaroi Hoxha.

EKONOMISTËT I SHKRUAJN DONALD TRUMPIT



PO RIKTHEHET DEPRESIONI I MADH

Më shumë se një mijë ekonomistë kanë paralajmëruar Donald Trump se proteksionizmi i tij ekonomik dhe retorikat e ashpra në tregti, kërcënojnë të përsërisin gabimet që SHBA bëri në vitet 1930, gabime që e zhytën botën në depresionin e madh.

Trump ka vendosur tarifa mbi importet e hekurit dhe aluminit, por ka përfunduar përkohësisht nga aplikimi i tyre BE, Australinë dhe disa vende të tjera. "Në 1930, 1028 ekonomistë i kërkuan kongresit të hiqte dorë nga akti pro-

teksionist që njihet si "tarifat Smoot-Hawley", shkruanin autorët duke cituar një akt tregtar që shumë ekonomistë e konsiderojnë një prej shkaqeve të depresionit të madh.

Sot, amerikanët përballesh me një aktivitet të ri proteksionist, përfshirë kërcënimet për t'u tërhequr nga marrëveshjet tregtare, thirrjet për tarifa të reja si reagim ndaj mungesës së balancës tregtare dhe tarifave mbi lavatritë, panelet diellore e madje edhe hekurin dhe aluminit që

përdoret nga prodhuesit amerikanë. Kongresi, nuk e dëgjoi këshillën e ekonomistëve në 1930 dhe amerikanët në të gjithë vendin paguan çmimin.

Ekonomistët dhe pedagogët e ekonomisë që kanë nënshkruar këtë letër, ju kërkojnë ju të mos e përsërisni atë gabim. Ka ndryshuar shumë nga 1930, p.sh tregtia tani është shumë më e rëndësishme për ekonominë tonë, por parimet themelore siç janë shpjeguar që në atë kohë, nuk kanë ndryshuar".

Në fushatë zgjedhore por edhe pasi u ul në detyrë, Trump ka kërcënuar se do të shembë dekada marrëveshesh tregtare, përfshirë atë të tregtisë së lirë në Amerikën e veriut. Letra e ekonomistëve është nënshkruar nga mbajtës së çmimit Nobel, përfshirë Alvin Roth, Richard Thaler, Oliver Hart, Roger Myerson dhe James Heckman si edhe Jason Furman, ish-drejtuës i Këshillit Ekonomik të Barack Obamës dhe James Miller, drejtor buxheti i Ronald Reganit.



Itali, përpjekjen e fundit për të formuar qeverinë

Sergio Mattarella, presidenti i Italisë, do të bëjë një ofertë të fundit për të bindur partitë politike të vendit për të formuar një qeveri dhe për të shmangur zgjedhjet e reja. Qëndrimi i z. Mattarella për të pritur bisedime të mëtejshme partiake vjen dy muaj pasi partitë populiste euroskeptike fituan në zgjedhjet e përgjithshme, duke lëkundur institucionin politik të Italisë, por gjithashtu ata dështuan të siguronin një shumicë të qëndrueshme në parlament. Lëvizja Pesë Yje u shfaq si partia më e fortë pas votimit. Ajo është përpjekur dhe nuk ka arritur të negociojë marrëveshje me të dyja ligjet e ekstreme të djathtë, një parti tjetër që korri mbështetje e vota të konsiderueshme në zgjedhje, dhe partia e qendrës së djathtë Demokratike (PD), e cila pësoi humbje të mëdha. Bllokimi ka frustruar z. Mattarella, roli i të cilit si president është të gjykojë bisedimet, duke e detyruar atë në një përpjekje përfundimtare për të ndërmjetësuar një marrëveshje, shkruan FT. Nëse dështon, opsionet më të mundshme që mbeten do të ishin një qeveri e unitetit kombëtar, të drejtuar nga një kryeministër kompromisi, i zgjedhur prej tij, apo zgjedhje të reja këtë vit apo në fillim të vitit 2019.

Irani kërcënon me vazhdimin e programit atomik

Marrëveshja e Vjenës synon të pengojë që Irani të zhvillojë armë atomike. Deri tani me sa duket Irani i është përmbajtur kësaj. Kurse tani Irani kërcënon se do ta rinisë pasurimin e uraniumit.

Irani nuk ka dëshirë që të zhvillojë negociata të reja për marrëveshjen ndërkombëtare atomike. Ministri i Jashtëm i Iranit, Mohammad Javad Zarif tha në një video të publikuar në YouTube dhe në Twitter se vendi i tij as do të negociojë dhe as do ta pranojë marrëveshjen.

Në rast të braktisjes së Marrëveshjes nga Presidenti i SHBA Donald Trump, Irani do të tërhiqet



nga ajo. "Po të largohen SHBA nga Marrëveshja, as ne nuk do të rrimë," tha Ali Akbar Velajati, këshilltari për politikën e jashtme i kreut fetar të Iranit, Ayatollah Ali Chamenei, sipas televizionit sh-

tetëror. "Po të dalin SHBA nga Marrëveshja do të thotë se nuk ka më marrëveshje", i tha edhe Ambasadori i Iranit në Londër, Hamid Baeidinedschad CNN-it. Në këtë rast, vendi i tij është "i gatshëm të

kthehet në gjendjen e mëparshme".

Kjo do të sillte edhe marrëdhënie të reja me Organizatën Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore IAEA, tha diplomati. Si masa të mundshme diplomati përmendi rinisjen e pasurimit të uraniumit. Marrëveshja atomike e Vjenës e vitit 2015 midis Iranit dhe pesë fuqive me të drejtë vetoje të OKB-së dhe Gjermanisë synon të pengojë që Teherani të fitojë aftësitë për të zhvilluar armë atomike. Në bazë të Marrëveshjes, Teherani e ka reduktuar dukshëm pasurimin e uraniumit dhe ka lejuar kontrolle më të ashpra të IAEA.

Czaputowicz: BE duhet të reformohet


Ministri i Jashtëm polak Jacek Czaputowicz me 7 maj pritet të vijë në Shqipëri. Polonia njihet si një nga vendet më kritike ndaj politikës së BE-së, por mbështetëse e Shqipërisë. Në një intervistë për 'Gazetën Shqiptare' Ministri i Jashtëm shprehet se BE ka nevojë për reforma.

"BE vuan nga një deficit demokratik. Ne mbështesim rritjen e rolit të parlamenteve ndërkombëtare. Një thellim i mëtejshëm i integritetit evropian është plani i mundshëm për aq sa pranohet

nga shtetet dhe popujt që marrin pjesë në këtë proces", është shprehur Czaputowicz.

Ai shton më tej se Komisioni Evropian duhet që të kthehet në rolin e tij teknik në vend që të bëjë përpjekje për një politikë më të madhe. Ndërsa sa i përket tensioneve me BE-në Ministri i Jashtëm është shprehur se BE duhet të bazohet në rregulla universale që të zbatohen në mënyrë të barabartë në të gjitha shtete. "Ne jemi të shqetësuar për kriteret e paqarta që mund të çojnë deri në kufizimin

arbitrar të të drejtave të Shteteve Anëtare". Sa i përket pikëpamjeve të Polonisë për zgjerimin e Ballkanit në BE, Czaputowicz u shpreh, "Polonia e mbështet fuqishëm politikën e derës së hapur të BE-së. Zgjerimi është një nga pikat më të fuqishme... Qytetarët e Ballkanit Perëndimor kanë të drejtë të zgjedhin rrugën e zhvillimit. Ata janë evropian dhe BE ka detyrim për t'i pranuar këto vende, sigurisht nëse i plotësojnë kriteret e detyrueshme. Zgjerimi ka të bëjë me takime politike të nivelit të




lartë, vendosjen e kriterëve dhe hapjen e kapitujve. Ka të bëjë edhe me ndryshimin e jetës së njerëzve për pritsmëritë më të mira nga

reformat, modernizimin, qeverisjen e mirë, afrimin e ekonomive dhe njerëzve", u shpreh më tej Ministri i Jashtëm Polak. (MAPO)

80 VJET MË PARË, DUÇJA PUSHTOI ME GAZ MUSTARD ETIOPINË

Më 3 tetor 1935, diktatori italian, Benito Mussolini, pushtoi Abisini. Demonstrimi i forcës që anglezët bënë në Mesdhe dhe vendimi i Lidhjes së Kombeve për ta cilësuar "agresion" aktin e Romës, nuk ia ndali dot vrullin Duçës. Prej këtij momenti, edhe Hitleri mësoi të mos e përfillte më Londrën. Kush kërcënon duhet të jetë edhe në gjendje ta aplikojë kërcënimin. Në fund të shtatorit 1935, në mënyrë demonstrative, një flotë e madhe anijesh kaloi Ngushicën e Gjibraltarit dhe hyri në Mesdhe: ishin më shumë se njëqind anije të Marinës Mbretërore Britanike. Në krye qëndronte: HMS "Hood", kryqezori më i fuqishëm i kohës së vet, shoqëruar nga homologia thujse po aq e madhe HMS "Renown", si dhe nga dhjetë kryqezorë të tjerë të vegjël. Mirëpo duket se ekspozita e kërcënimit nuk bëri asnjë përshtypje tek ai të cilit i adresohet. Diktatori fashist i Italisë, Benito Mussolini, kishte bërë pak për ta fshehur synimin e tij të vërtetë: ai donte që sa më shpejt të ishte e mundur, të bënte një luftë pushtuese për të shtënë në dorë Etiopinë, sapo të skadonte koha e regjencës në Afrikën Lindore. Vendi i njohur edhe me emrin Abisinia, deri në atë kohë nuk ishte kolonializuar kurrë—duke përbërë të vetmen pjesë të Afrikës, veç Libisë, e cila sidoqoftë ishte në atë kohë nën protektoratin amerikan. E tashmë, Etiopia për të çuar në vend dëshirën e Mussolinit, duhej bërë pjesë e "Imperium Romanum" në Afrikë, ku bënë pjesë edhe Libia, Eritreja dhe Somalia. Prej muajsh të tërë, trupat italiane kishin nisur përgatitjet për sulmin. Ata ndërtuan në qytete port si Kismaayo, Merka dhe Mogadishu, baza për ndërtimin e transportin e anijeve, rrugë dhe aeroporte. Para 80 vjetëve, një çerek milioni ushtarë ishin tashmë gati të nisnin sulmin. Nga demonstrimi britanik i forcës në Mesdhe, Mussolini nuk desh t'ia dinte. Pasi ai e dinte nga raportet e agjentëve të tij në terren, se të dyja anijet madhore britanike, të ndërtuara pak para nisjes së Luftës së Parë Botërore, do të tejkaloheshin nga të reja, të ndërtuara nga fuqitë e Boshtit. Sigurisht se "The Hood" dhe "The Renown", në atë kohë mund të përballonin çdo sulm italian e çdo armë të prodhuar nga Roma. Aq më tepër që të dyja anijet e rëndësishme të Flotës Ushtarake Mbretërore italiane, në vitin 1935 ndodheshin në një proces rindërtimi dhe përfundimi i tyre kërkonte kohë. Mirëpo Mussolini luante lojën që luante edhe homologu apo dhe shefi i tij në Berlin, Hitleri. Duçja këmbëngulte se demokracia shumëdebatuese e Britanisë, nuk do të mund të gjente dot gjuhën e përbashkët për të ndërmarrë hapa të dhunshëm ndaj aksioneve të tij. Herët në mëngjesin e datës 3 tetor 1935, trupat e tij kaluan pa bërë më parë asnjë deklaratë lufte, kufirin me Etiopinë. Sigurisht se do të kalonin shumë orë dhe kolonat e tankeve e automjete-



ve ushtarake do të duhej të ndalnin udhën e tyre si pasojë e mungesës së rrugëve "normale", duke u detyruar të marshonin më këmbë

në vendin mitik. Me flamuj në duar dhe gjëmime trombetash, ata çanin përpara. Të mbështetur nga luftëtarë e krerë fisesh eritrejas, që e urrenin fqinjin për vdekje, ata ishin të motivuar ta arrinin shpejt

qëllimin. Zaptuan si pasojë edhe qytetet e para, Adua dhe Axum. Benito Mussolini me ç'duket i kish bërë mirë llogaritë: Flota Britanike në Mesdhe nuk ndërhyri. Sidoqoftë, Lidhja e Kombeve me seli në Gjenevë, që deri në atë moment u duk si inekzistente, e cilësoi menjëherë si "agresion" aktin ushtarak italian. Ishte hera e parë që ky gjykim formal kaq i ashpër, ishte shprehur hapur prej saj. Në Berlin, në fillim pati ca shqetësime për këtë hap të aleatit të Fyhrerit. Raporti me Italinë fashiste ishte në atë moment shumë i tensionuar në fakt, pasi Mussolini shihej si "engjëlli mbrojtës" i qeverisë "reaktionare katolike" të Austrisë, që binte ndesh me objektivat e Hitlerit. Në Vjenë, madje, një vit më parë, kishte dështuar një tentativë për puç—falë kundëraktivitetit diplomatik të drejtuar nga Roma. Ekspertët e Ministrisë së Jashtme gjermane analizuan më 7 tetor 1935, se si do të mund të ndikonin sanksionet eventuale të Lidhjes së Kombeve ndaj Italisë, mbi interesat gjermane. Pikërisht në atë moment, në Gjenevë pati konsulta mbi masa ndëshkimore ekonomike ndaj Romës. Diplomatat në Berlin bënë përlllogaritjet që lidheshin me pla-

net e Mussolinit: "Deri më tani, Italia e kishte cilësuar ndërmarrjen e saj në Abisini, jo si luftë, por si një ekspeditë koloniale". Gjithçka kishte qenë, sikurse thanë ata, thjesht një "fiction" nga kundërshtarët e Italisë. Në fakt, Lidhja e Kombeve vendosi sanksione kundër diktaturës së Mussolinit. Sidoqoftë, me "pak sens humor", siç do të konstatonte më pas me cinizëm një analist. Pasi u ndalua nga njëra anë, tregtia e gamileve, e mushkave dhe e aluminit, por jo eksporti i hekurit, qymyrit e para së gjithash i naftës drejt Italisë. Qysh më 15 tetor 1935, Italia e justifikoi sulmin e saj me idenë se do të shfuqizonte skllavërinë e do të sillte përparimin në Abisini. Në realitet, në vend të formës tradicionale të organizimit të shoqërisë atje, vetëm se kishte futur një formë të re të shtypjes dhe shfrytëzimit—këtë radhë nga zotërinjtë kolonialë italianë. E sigurt është se trupat italiane, në një masë të madhe, përdorën edhe gazin mustard kundër rezistencës lokale etiopiane, një armë e përçmuar qysh në atë kohë nga komuniteti ndërkombëtar, që ia dinte efektet qysh nga Lufta e Parë. Me arsyetimin se atje fshihej kundërshtari, u sulmuan me gaz helmues edhe qyteza të vogla e fshatra me civilë të pafajshëm. Pati ekzekutime në masë, vrasje pengjesh dhe krime të tjera lufte, si për shembull sulme mbi objektiva të mbrojtur ndërkombëtarisht, si spitalet e Kryqit të Kuq. Megjithatë, sanksionet e Lidhjes së Kombeve nuk u forcuan dhe të dyja anijet e Marinës Mbretërore Britanike, kryen asokohe vetëm manovra në pjesën lindore të Mesdheut apo ngulën spirancën në brigjet e Aleksandrisë. Më 10 maj 1936, i besuari i Hitlerit, Joseph Goebbels, në ditarin e tij do të shënonte: "Mussolini po anekson të gjithë Abisini. Londra e dekurajuar tërësisht. Nëpërmjet politikës së saj të dobët". Dhe ai shtonte më tej: "Edhe një fuqi botërore si Anglia, nuk mund ta ndalë dot". Kërcënimet e qeverisë britanike nuk kishte pasur efekt, pasi nuk ishte marrë seriozisht. Te Hitleri, kjo eksperiencë do të zinte rrënjë, duke e kurajuar në rrugën e tij. Pas saj, që nga ai moment, ai do t'ia kishte gjithnjë e më pak frikë politikanët në Londër. Ndërsa për Romën do të shërbente më së miri si test për të kaluar në pushtimin e radhës, atë të Shqipërisë në brigjet përballë, akt për të cilin çuditërisht sërish hasi në mesfshësinë e Londrës, e cila u konsiderua gjerësisht si një miratim në heshtje për aktin e Mussolinit, pasojat e të cilit do të shiheshin të kishin efekt shumë shpejt.

(Gazeta-Shqip)



Skuadra e FC Shkupi dhe KF Renova kanë edhe një shans për të shpresuar se mund të kapin pozitën e katërt. Të dyja skuadrat janë ende në garë për vendin e katërt, që mund ti qojë në Evropë, nëse Shkëndija fiton Kupën e Maqedonisë

LIGA E PARË, JAVA E 33

SHKUPIT E RENOVËS U NEVOJITET VETËM FITORJA PËR EVROPËN



DYSHET:
RENOVA - VARDARI
PELISTERI - A. PANDEVI
SKOPJE - FC SHKUPI
SILEKSI - SHKËNDIJA
RABOTNIČKI - POBEDA

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 4 maj - Në Tetovë po e përgatisin me shumë kujdes ndeshjen e së dielës me Vardarin në stadiumin e qytetit në Tetovë, sepse duhet ta fitojnë patjetër për të mbetur në garën e vendit të katërt, që aktualisht është vetëm dy pikë, derisa larg vendit të tretë janë vetëm gjashtë pikë. Deri në fund Renovës i kanë mbetur edhe katër ndeshje, përfshi këtu ndeshjen e së dielës me Vardarin dhe gjithçka mund të arrihet. Po ashtu, "gjipspunuesit" luajnë para tifozërisë së tyre dhe nuk duhet të bëjnë edhe një hap fals në këtë ndeshje, pas disfatës në Manastir ndaj Pelisterit javën e kaluar. Për këtë sfidë mjaftë të rëndësishme për gazetën KOHA, ka folur njëri prej futbollistëve më të mirë Mexhit Neziri. "Atmosfera në ekip është shumë e mirë. Derisa ka gjasa teorike do të shpresojmë për vendin e katërt, që donë të thotë se të dielën duhet patjetër ta mundim Vardarin. Besojmë se me një angazhim maksimal i të gjithë futbollistëve, do t'ia arrijmë qëllimit. Gjithashtu be-

sojmë edhe në referim të barabartë në këtë sfidë duke marr parasysh se këtë sezon ata kanë qenë shumë herë kundër Renovës dhe kjo nuk na le të mendojmë se në ndeshjen me Vardarin do të kemi referim real. Çdo ndeshje presim se do të na dëmtojmë, pasi kjo disa herë ka ndodhur", deklaroi Neziri.

Në anën tjetër, edhe në radhët e FC Shkupi janë përgatitur me shumë kujdes për sfidën me

"Skopjen" në lagjen Hekuran. Djemtë e trajnerit Zekirja Ramadani duhet patjetër ta fitojnë këtë ndeshje për të mbetur në garë për vendin e katërt, por edhe të mos lejojnë që në fund të "luftojnë" për balotazh, pasi nga kjo pozitë ata janë larg vetëm pesë pikë. Derisa, nga pozita e katërt bardhekaltërit i ndanë katër pikë, por ata kanë një ndeshje më pak, atë me Pelisterin në Çair të cilën do ta zhvillojnë më

9 maj. Pra FC Shkupi deri në fund duhet të zhvillojë edhe pesë ndeshje dhe gjithçka mund të arrihet aq më tepër që edhe kalendari i favorizon pak, pasi më pasi nga pesë përballjet, tre i zhvillon në fushën e saj. Pas "Skopjes" të dielën, Shkupi në Çair do të presë Pelisterin (ndeshjen e mbetur) dhe Renovën, ku këta të fundit i ka rival për vendin e katërt. Por, bardhekaltërit kanë edhe një "hak" për të marr në nde-

shjen e së dielës, për shkak të disfatës me 0-2 që ia shkaktuan ata në Gostivar. Mesfushori Stefan Vujčić, i cili dal nga dal po rikthehet në formën e tij të mëhershme thotë se nuk kanë se çka të kalkulojnë dhe se fillimisht dëshiron të siguron mbijetesën dhe më pas të vazhdojnë garën për Evropë. "Do të jetë ndeshje interesante. 'Skopje' meriton respekt, veçanërisht pas rezultateve në pjesën e dytë të sezonit. Por, duhet të potencoj se neve na intereson vetëm fitorja. Dëshirojmë të sigurojmë mbijetesën, por njëkohësisht të mbesim në garë për Evropën. Kështu që nuk ka shumë kalkulime, pasi që as ne e as atyre nuk na përshtatet barazimi", deklaroi për faqen e klubit, Vujčić. Ndërkohë, sfidë interesante do të zhvillohet në arenën "Filipi i dytë", mes Rabotniçkit dhe Pobedës. Të parët po "luftojnë" për Evropë, derisa Pobeda për mbijetesë. Derisa për mbijetesë do të jetë edhe sfida mes Pelisterit dhe Akademia Pandevit, ndërsa kampioni i ri Shkëndija në Kratovë do të sfidohet nga skuadra e Sileksit. Ndeshjet e javës së 33 në LPFM-së do të fillojnë në ora 16.30.

Latifi duel me brazilianin në UFC Hamburg

Pak ditë më parë ishte në Tiranë për të promovuar sportin e arteve marziale mikse dhe takuar fansat e tij, duke mos bërë me dije emrin e rivalit, por sot është zyrtarizuar gjithçka. Shqiptari i vetëm i UFC-së, Ilir Latifi, do të duelojë më 22 korrik në Gjermani ndaj brazilianit Glover Teiksiera, duel i vlefshëm për evenimentin e UFC-Hamburg. Kjo është një përballje e fortë mes dy rivalësh në peshën "light heavyweight", madje do të duelojnë për fitoret numrat 3 dhe 4 të këtij divizionit. Ndryshe, Teiksiera, 10 fitore e 4 humbje në kafaz, vjen pas dy fitoreve në 3 përballjet e fundit, ndërsa Latifi (14 fitore, 5 humbje e 1 barazim) ka fituar 5 nga 6 duelet e fundit. Kjo përballje pritet me interes, pasi fituesi mund të marrë titullin kampion botë të përkohshëm në këtë peshë dhe në të ardhmen të duelojë me kampionin e kësaj kategorie, Luke Rokhold. Për shqiptarin ky është një shans i madh në karrierën e tij, pasi më në fund i jepet mundësia që të duelojë për majat e këtij sporti.



Shaqiri në fund të sezonit vendos të ardhmen



Xherdan Shaqiri do të ketë bisedime me Stok Sitin për të vendosur rreth të ardhmes së tij. Shaqiri sivjet ka realizuar shtatë gola dhe gjashtë asistime për klubin që rrezikon të largohet nga Premier Liga. Ish-anësori i Bajern Munihut dhe Interit, kaloi te Stok në vitin 2015 dhe kontrata i skadon në verën e vitit 2020. Kur është pyetur për mundësinë e largimit gjatë verës nëse Stok bie në rangun më të ulët, 26-vjeçari ka thënë. "Të gjithë e dinë se jam lojtar që dëshiron të luajë në nivelet e larta - kjo është shumë normale. Por i kam edhe dy vjet në kontratën me këtë klub. Duhet të shohim se çfarë ndodh këtu. Jam i lumtur për momentin dhe kam edhe dy vjet kontratë. Pas këtij sezoni do të ulemi dhe bisedojmë", deklaroi Shaqiri.

Në verë do të lëviz nga Atletiko

Mesfushori fierak i Kombëtares, Keidi Bare, ka pranuar se në verë do të lëvizë nga Atletiko e Madridit, por pa përmendur emra skuadrash për të ardhmen e tij. "Tek Atletiko Madrid ka shumë konkurrencë, pasi janë lojtarë klasë, por për momentin jam këtu. Mendoj se në verë do të bëj ndonjë lëvizje, por emra konkretë skuadrash nuk ka", shprehet Bare, i cili është dënuar me 9 ndeshje në Spanjë, pas kartonit të kuq të marrë për protesta të ekzagjeruar ndaj arbitrit, por shpreson që ky

dënim t'i ulet. Mesfushori kuqezi ka folur edhe për kalimin në finale të Atletikos së Madridit. "Tifozët janë të çmendur pas kësaj skuadre. Edhe pse u eliminuam nga 'Champions League', shkuam në finalen e 'Europa League' dhe kjo është diçka fantastike. Forca e skuadrës janë mbrojtja dhe portieri Oblak, që pëson shumë pak gola. Megjithatë, të gjithë japin shpirtin në fushë dhe kjo skuadër bazohet te grupi. Atletiko nuk e donte Marsejën në finale, por futbollit ky është", deklaroi



DHJETË ARSYE PËR TË MOS HUMBUR "EL CLASICO"

Barcelona e ka siguruar titullin në La Liga me fitoren e marrë në fushën e Deportivo la Korunja të dielën e kaluar, ndërsa Real Madrid ka siguruar vendin e tretë në renditje dhe, pavarësisht se dy skuadrat nuk kanë asgjë për të luajtur në "El Clasico"-n e së dielës, më poshtë janë renditur 10 arsye pse nuk duhet ta humbisni.



1. Do të tregojë cila është skuadra më e mirë

Pavarësisht se Barcelona e ka fituar titullin, nuk ka asnjë mënyrë më të mirë për të treguar se cila është skuadra më e mirë e Spanjës së përballja direkte mes dy rivalëve të përrjeshëm.

2. Është "El Calsico" e fundit për Andres Iniesta

Pas 37 ndeshjesh kundër Real Madrid, mesfushori veteran do të luajë "El Clasico"-n e fundit të dielën. Ai është një ikonë e futbollit spanjoll dhe ka marrë pjesë në disa përballje të paharrueshme me "Los Blancos" gjatë karrierës së tij.

3. Korridor i nderit

Kampionët e Evropës në fuqi kanë vendosur se nuk do të formojnë një korridor nderi për rivalët katalanas dhe "blaugranat" nuk e kanë marrë mirë këtë vendim. Edhe pse është cilësuar si një problem shumë i vogël, do t'i shtojë pak piper sfidës.

4. Mund të vendoset fituesi i "Pichichi"-t

Lionel Messi ka katër ndeshje në dispozicion për të siguruar titullin e

golashënuesit më të mirë të la Ligas, por dy ndjekësit e tij më të afërt, Ronaldo dhe Suarez, do të jenë gjithashtu në fushë të dielën. Argjentinasi ka shënuar 32 gola, ndërsa KR7 dhe Ronaldo kanë realizuar 24 dhe 23 respektivisht.

5. Barcelona është e pamposhtur në kampionat

Objektivi Ernesto Valverdes për pjesën e mbetur të sezonit është që ta mbyllë kampionatin pa humbje. Barcelona nuk ka

humbur asnjë nga 41 ndeshjet e fundit të La Ligas dhe nuk mund të ketë motivim më të madh për marrëdriljen sesa t'ia mohojnë këtë arrijtje rivalëve historikë.

6. Messi dhe Ronaldo janë në fushë

Është e rrallë që dy yje të tillë të luajnë në të njëjtën kohë dhe ne kemi qenë të bekuar për t'i parë Messin dhe Ronaldon në kulmin e tyre. Ata do të jenë të dy në fushë të dielën për të shkruar një tjetër faqe në historinë e rivalitetit të tyre në fushën e lojës.

7. Barcelona mund të fitojë një "El Clasico" në shtëpi për herë të parë që nga sezoni 2014/15

Katalansit nuk fitojnë një "El Clasico" në shtëpi që nga sezoni i parë i Luis Enrique në drejtim të Barcelonas. Ata do të kenë mundësinë ta bëjnë këtë kundër një Real-i të lodhur nga "Champions league".

8. Shumë yje në fushën e lojës

Edhe nëse të dy trajnerët do të

përdorin rotacionin, përsëri do të kishte shumë yje në fushën e lojës. Real Madrid dhe Barcelona janë dy zgjedhjet e para për shumë lojtarë në të gjithë botën dhe kjo i ndihmon dy klubet të kenë lojtarë cilësorë edhe në stol.

9. Lojtarët do të jenë të motivuar

Teksa pjesa më e madhe e ndeshjeve nuk kanë asnjë interes në fundin e sezonit, me lojtarët që fillojnë të bëjnë planet për pushimet e verës, e kundërta vlen për Barcelona-Real Madrid. Të gjithë lojtarët ëndërrojnë të jenë pjesë e një përballje të tillë.

10. Atmosfera politike në Spanjë

Ndeshja e së dielës do të jetë "El Clasico" e parë që do të luhet në Barcelona që nga koha kur lëvizja për Pavarësinë e Katalonjës fitoi popullaritet tetorin e kaluar. Atmosfera në stadium pritet të jetë shumë e politizuar për shkak të qëndrimit të Madridit.

Publicitet

UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI" - SHKUP
INSTITUTI EKONOMIK - SHKUP
Në bazë të nenit 131 dhe nenit 135 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016 dhe 127/16), nenit 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup — teksti i pastruar ("Lajmëtar universitar" nr. 274/13) dhe nenet 41 paragrafi 1 alineja 8, nga Rregullorja për marrëdhëniet e brendshme dhe punën e Institutit ekonomik në Shkup në përbërje të Universitetit "Shën. Kirili dhe Metodi" Shkup (Lajmëtar universitar nr. 130/2009 dhe 288/2014), drejtori i Institutit ekonomik publikon

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor,
SH P A L L J E
Projekt A – Leje e integruar ekologjike
Në përputhje me nenin 138 paragrafi 5 të Ligjit mjedisit jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar Njoftim nga Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor nga inspektimi i kryer dhe Procesverbal i përgatitur nr. 11-896/2 nga 27.02.2018 v me të cilin njoftojnë se detyrimet nga plani operativ janë realizuar dhe mund të fillohet me procedurën për kalim nga A-Leja për harmonizim me planin operativ nr. 11-1872 nga 20.02.2014 në A-Leje të integruar ekologjike.

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për arsim fillor dhe nenit 71 paragrafi 1 alineja 7 e Statutit të SHFK "Krste P. Misirkov" Radovich, Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur më datë 04.05.2018, publikon
SH P A L L J E
Për zgjedhje të drejtorit të shkollës
Kushtet: Për drejtor të Shkollës fillore zgjidhet drejtor i cili krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj, i përmbushë edhe kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore dhe ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimor, provim të dhënë për Drejtor dhe test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.
Mandati i drejtorit zgjatë 4 (katër) vjet dhe fillon të rrjedhë nga dita e sjelljes së Vendimit për zgjedhje nga ana e Kryetarit të Komunës.
Kandidatët e interesuar krahas lutjes, duhet të parashtrojnë diplomë për arsim të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter), certifikatë për provim të dhënë për Drejtor, certifikatë se nuk është i dënuar, vërtetim për përvojën e punës, certifikatë të shtetësisë, certifikatë të mjekut dhe vërtetim/certifikatë për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.
Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor.
Dokumentet e nevojshme parashtrohen në adresën e SHFK "Krste P. Misirkov" Radovich, bul. Aleksandar Makedonski nr. pn, Radovich ose në arkivin e shkollës.
Këshilli i shkollës pranë SHFK "Krste P. Misirkov" Radovich,
Kryetar,
Tatjana Gjozeva

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
e Republikës së Maqedonisë
SH P A L L
Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit, në lokacionin PK 91 , KK Moin komuna e Gjevgjeli.
Në pajtim me nenin 30 paragrafin 1 të Ligjit të Ujërave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit për ujitje në lokacionin PK 91 , KK Moin komuna e Gjevgjeli, me numër të arkivit nr. UP1-11/5-481/2018 prej 27.03.2018.
Parashtruesi i kërkesës:
"VETERINAR" SHPK Gjevgjeli
Rr. Moinski pat 221 Gjevgjeli
Koordinatat e pusit eksploatuese PK 91 , KK Moin komuna e Gjevgjelisë, sipas sistemit shtetëror koordinativ:
Pusi X-623112 i Y-455461
Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail H.Rexhepi@moepp.gov.mk
Publiku i tanguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së kërkesës, ka të drejtë që të dorëzojë mendime dhe komente në formë të shkruar në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bul. "Goce Dellçev" nr. 18 ndërtesa e RTM (kati i 10), 100 Shkup.

LAJMËRIM
Fakulteti juridik "JUSTINIANI I PARË" në Shkup lajmëron se më datë 14.05.2018 (e hënë) në ora 11, kandidati M-r Sanja Tomiq do të mbrojë disertacionin e doktoratës me temë:
"E drejta ndëshkimore për mbrojtjen e fëmijëve që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeçare"
Mbrojtja do të mbahet në sallën për takime në Fakultetin juridik "Justiniani i parë" - Shkup, Bul. "Goce Dellçev" 9b - Shkup (salla e NNS nën dekanat)
Nga Fakulteti juridik
"JUSTINIANI I PARË" Shkup

URGJENTISHT
Shtet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

MERKATO E MILANIT

OBJEKTIVI I GATUSOS ËSHTË MANXHUKIÇI

Rastësi që sulmuesi kroat, i cili për disa muaj pothuajse me siguri do të largohet nga Juventus, sipas "Corriere dello Sport", do të bëhet një nga objektivat, nëse jo qëllimi i parë i Milanit për sulmin



Juventus ofron 60 mln euro për Moratan

Juventus është gati t'i ofrojë Çellsit 60 milionë euro për sulmuesin Alvaro Morata, raporton "Tuttosport". Futbollisti spanjoll luajti te bardhezinjtë e Torinos nga viti 2014 deri më 2016, para se të kthehej te Real Madridi dhe pastaj të transferohej te Çells, verën e kaluar. Pas një sezoni të vështirë të parë në "Stamford Bridge", Juventus shpreson që një ofertë fillestare huazimi prej 15 milionë euro, plus një pagesë tjetër prej 45 milionë euro, do ta joshë 25-vjeçarin përsëri, për t'u rikthyer në Torino. Në eksperiencën e parë, sulmuesi spanjoll ka luajtur 93 ndeshje me "Zonjën e Vjetër", duke shënuar 27 gola, 7 prej të cilëve në Ligën e Kampionëve.



Cilësia, por mbi të gjitha përvoja. Këto do të jenë dy parullat, që do të udhëheqin merkaton e transferimeve të Milanit për sezonin 2018-2019. Të gjitha, me kërkesë të saktë të Xhennaro Gattuso. Trajneri aktual i kuqezinjve do ta kishte kërkuar të blinte lojtarë më të pjekur, të aftë të tërhiqnin skuadrën përpara dhe të dinin si të fitonin. Pikërisht, identikit i Mario Manxhukic, për shembull. Rastësi që sulmuesi kroat, i cili për disa

muaj pothuajse me siguri do të largohet nga Juventus, sipas "Corriere dello Sport", do të bëhet një nga objektivat, nëse jo qëllimi i parë i Milanit për sulmin. Kroati (32 vjeç në fund të muajit) në karrierën e tij, megjithatë ka fituar gjithçka dhe përkundër një karakteri ekspresiv në dukje ka qenë gjithmonë lider në klube dhe ekipin kombëtar. Ashtu si Pepe Reina. Kroati, i cili në janar nuk ka pranuar të shkojë në Kinë, ende dëshiron të konkurrojë

në nivele të larta në futbollin evropian dhe Milani do t'i jepte atij mundësinë të kthehet në lojë si "violinë e parë". Për të bindur Juventusin, nga ana tjetër, kuqezinjët do të kenë nevojë për jo më pak se 20-25 milionë euro. Përveç Reinas dhe Manxhukic, sipas "Tuttosport", Milani në javët e fundit do të mendojnë seriozisht edhe për një tjetër lojtar me përvojë dhe shtat ndërkombëtar, si Fellaini, kontrata e të cilit me Mançester Junajtedin

i skadon në qershor. Megjithatë, konkurrenca nuk mungon në këtë rast. Së fundi, siç lexojmë në "La Gazzetta dello Sport", në një takim në Madrid me drejtorin sportiv Mirabelli, Jorge Mendes do të flasë për të ardhmen e Andre Silvas, i cili mund të largohet nga Milani pas një sezoni dhe të zhvendoset në Monako, në klubin e Principatës. Të gjitha janë vetëm hipoteza, megjithatë, të paktën për momentin.

Murinjo heq dorë nga Umtiti, synon Klaivertin



Mançester Junajtedi e ka zbehur interesin e vet për qendërmbrojtësin Samuel Umtiti, sipas "Marca". Umtiti po kërkon një kontratë të përmirësuar në "Camp Nou" dhe skuadra e drejtuar nga Hoze Murinjo mendohej se ishte një vend i mundshëm për të, nëse Barcelona nuk paraqiste një marrëveshje të pranueshme. Por Umtiti tani ka gjasa të bjerë dakord për një marrëveshje të re në "Camp Nou", ndërsa Mançestri e sheh veten jashtë "tablosë". Edhe PSZH nuk ka gjasa të bëjë

një ofertë, për shkak të shqetësimeve financiare të "Fair Play". Nga ana tjetër, anglezët e "Old Trafford" kanë shfaqur interes për Xhastin Klaivert, sulmuesin e i të Ajaksit. 18-vjeçari është bërë një nga perspektivat më të nxehta të Evropës, duke shënuar 9 gola në 29 ndeshje për holandezët, këtë sezon. Raporti mediatik i "Mirror" thotë se Klaivert është gati të rishkruajë një marrëveshje, që do ta bënte atë lojtarin më të paguar te Ajaksi, në mënyrë që të testojë tregun këtë verë.

HISTORIA E PABESUESHME E LOJTARIT TË LIVERPULIT

Nga i papunë, te finalja e Ligës së kampionëve

Ka histori që meritojnë të tregohen dhe që mund të frymëzojnë shumë të rinj që ëndërrojnë të kenë sukses në botën e sportit, duke luftuar mijëra vështirësi. Një histori e tillë është ajo e Andre V Robertson, një që sapo ka siguruar një finale të "Champions League" me Liverpul dhe që do të provojë të shkruaj një faqe historike të futbollit, duke mundur Real Madridin. Pikërisht ai që në 2012-ën e largët ndiqte ëndrrën që të bëhej futbollist profesionist, por duke luftuar me papunësinë e tij dhe duke shprehur gjithë pakënaqësinë në rrjetet sociale. Në atë kohë ishte 18 vjeç dhe luante me Kuins Park. Paratë mungonin dhe mbrojtësi i majtë ka mbajtur gjallë ëndrrën e tij mes shumë sakrificave. "Jeta pa para në këtë moshë ta shpif. Më duhet një punë", shkruante Robertson në 2012-ën. Një "cicërimë" që ai nuk e ka fshirë kurrë dhe që sot ka një shije shumë të veçantë. Po, sepse gjërat

kanë ndryshuar shumë që nga ajo kohë për Robertson, i cili do të ketë mundësinë ta kurorëzojë ëndrrën e tij me një fitore në finalen e "Champions League" 26 majin e ardhshëm.



Markisio, përjetësisht te Juventus

Klaudio Markisio ka vendosur: do të qëndrojë përjetësisht te Juventus. Palët janë afruar, pavarësisht nga aktivizimi i pakët e mesfushorit bardhezi në këtë sezon. Në fund të kampionatit do të ketë një takim mes tij dhe Beppe Marotta dhe "Princi" do t'i pohojë drejtuesit bardhezi synimin për të respektuar deri në fund kontratën deri në vitin 2020, kur do të mbushë 34 vjeç. Me shumë mundësi për të do të jetë kontrata e fundit.

Drejtuesit e "Zonjës së Vjetër",

prej disa javësh po punojnë për të projektuar sezonin e ri. Moratta ka si detyrë kryesore të punojë për të gjetur mbrojtës krahu. Lihstainer dhe Asamoah do të largohen në fund të kontratës dhe parashikohet edhe largimi i Aleks Sandro. Ashtu si bën të ditur "Tuttosport", administratori i deleguar do të intesifikojë bisedimet me Lukas Digne, 24-vjeçari i Barcelonës. Ndërkohë do të rikthehet nga huazimi Leonardo Spinazzola, që sivjet luajti me Atalantan.



ATLETIKO MADRIDI DHE OLIMPIK MARSEJË NË FINALEN E LE

SHKRUAM FAQEN E PARË TË HISTORISË SË "METROPOLITANO"

"Historia jonë është bërë në kësi lojërash. Stadiumet duhet të jenë fortesa, me lojërë dhe fitore të mëdha, si kjo, – tha argjentinasi nëpërmjet UEFA-s. – Ndieja se si atmosfera ishte. Tifozët ishin me ne në çdo hap të rrugës, ata e dinin se skuadra do t'i shpërblente. Kjo është një nga faqet e para, që kemi shkruar në historinë e stadiumit tonë të ri, "Wanda Metropolitano", pohon Simeone



nga skuadra e tij. Dy herë fitues të këtij kompeticioni, spanjollët arritën në finalen e Ligës së Evropës për herë të tretë në një "magji" 9-vjeçare, që u ka dhënë atyre edhe dy finale të Ligës së Kampionëve. "Historia jonë është bërë në kësi lojërash. Stadiumet duhet të jenë fortesa, me lojërë dhe fitore të mëdha, si kjo, – tha argjentinasi nëpërmjet UEFA-s. – Ndieja se si atmosfera ishte. Tifozët ishin me ne në çdo hap të rrugës, ata e dinin se skuadra do t'i shpërblente. Kjo është një nga faqet e para, që kemi shkruar në historinë e stadiumit tonë të ri, "Wanda Metropolitano". Ne jemi të kënaqur, që shkojmë në

finalen e Lion. Kemi dashur të kthehemi në finale që nga ajo e fundit, që e arritëm. Skuadra u përgjigj aq mirë javën e kaluar. Portieri Jan Oblak bëri një lojë të mrekullueshme. Sidoqoftë, ky është kualifikim i grupit, sepse krejt ekipi ka qenë me të, në atë nivel. Ne punuam mirë këtë javë dhe ndihemi mirë që po shkojmë në finale", deklaroi Simeone. Ndwsa, trajneri i Arsenalit, Arsen Wenger ka folur pas ndeshjes ku ka deklaruar se është shumë i zhgënjyer me eliminimin. "Edhe unë si pjesa tjetër e ekipit jam shumë i zhgënjyer. Jam i trishtuar nga kjo humbje. Jam zhgënjyer shumë nga

SULMOHET OZIL PAS ELIMINIMIT TË ARSENALIT

Eliminimi i Arsenalit në gjysmëfinale të "Europa League", kundër Atletico Madridit, ka provokuar kritika ndaj Arsen Wenger. Asgjë nuk shko mirë me ekipin e Londrës për shkak të performancës së dobët në "Eanda Metropolitano", ku nuk ishte në gjendje të përballë me të kuqebardhët, as të krijonin shumë rrezik. Një nga më të ekspozuarit ndaj kritikave është Mesut Ozil. "Ai nuk e meriton ta veshë këtë fanellë. Nuk e di se çfarë mund të bëjë trajneri i ri. Është një problem i madh për të, sepse Wenger ka investuar një sasi të madhe parash për Ozil, por ai nuk e meritonte ta vishte këtë fanellë, sonte. Dhe unë e kam parë në këtë gjendje shumë herë këtë sezon. Është e nevojshme të thuhet, sepse ne presim më shumë prej tij, ai është një kampion botëror", – shpjegoi Martin Keon, ish-lojtar i Arsenalit. Ndryshe, shumica e gazetave angleze theksojnë fuqinë e Diego Kosta. Brazili i ishte jetik në rikthimin e gjysmëfinaleve, pati një performancë të shkëlqyer gjatë ndeshjes dhe ishte gjithashtu autori i golit të qetësisë së kuqebardhëve. "Daily Mail" thotë: "Diego Kosta i mohon Vengerit ëndrrën e një finalisti europian". "The Guardian" ndjek të njëjtën linjë: "Diego Kosta shënon fundin e epokës së Venger". "The Sun" hapet me titullin: "Ëngjer out", e shoqëruar nga një foto e lojtarit brazilian.



eliminimi në këtë fazë. Unë jam shumë i trishtuar që po e lë klubin në këtë mënyrë", deklaroi tekniku francez. Ndërkohë, në finale, Atletico do të përballë me skuadrën e Olimpik Marsej. Skuadra franceze ka shënuar gol në minutën e 114 të takimit në shtëpi të Salzburg, një

gol i artë ky që e e kualifikojë atë si finalistin e dytë të kësaj gare. Ndryshe, 180 minuta të dy gjysmëfinaleve nuk prodhuan fitues por ai u përcaktua pas minutave shtesë të këtij takimi. Finalistin e vendosi goli i Rolandos, që i dërgoi francezët në finale të "Europa League".

Publicitet

Republika e Maqedonisë
Qeveria e Republikës së Maqedonisë

THIRRJA E PARË PUBLIKE PËR FINANCIM TË PROPOZIM PROJEKTEVE

në kuadër të planit për rritje ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë – shtylla 3

www.fitr.mk/stolb3/

ÇKA OFROHET?

Mbështetje e drejtpërdrejtë financiare për zhvillim teknologjik dhe inovacione për mikro ndërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe të mesme me qëllim të përfundimit të konkurrencës, punësimit dhe rritjes.

Në mënyrë shtesë, është zhvilluar instrument i posaçëm për mbështetje në përsosmëri profesionale të personave të rinj posa të punësuar.

Grante të kofinancuara për mikro ndërmarrje – financim deri në 30% të buxhetit të përgjithshëm të projektit investues, në shumë prej 5.000.000,00 denarë për aplikues.

01

Grante të kofinancuara për ndërmarrje të vogla dhe të mesme me tendencë për rritje të shpejtë, a.q. "gazela" – financim deri në 30% të buxhetit të përgjithshëm të projektit investues në shumë prej 10.000.000,00 denarë për aplikues.

FITR.MK/GAZELI

02

FITR.MK/MICRO

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Të gjitha mikro ndërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të themeluara në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe të regjistruara në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë me obligime dhe borxhe të paguara, kundër të cilave nuk janë ngritur procedura falimentimi ose procedura për likuidim.

03

Grante të kofinancuara për përmirësimin e inovacioneve – financim deri në 70% të buxhetit të përgjithshëm të projektit investues, në shumë prej 20.000.000,00 denarë për aplikues.

FITR.MK/INOVATIVNOST

04

Grante të kofinancuara për përsosmëri profesionale dhe praktike për të rinjtë e posa punësuar – financim deri në 30% të buxhetit të përgjithshëm të projektit investues në shumë prej 1.000.000,00 denarë për aplikues.

FITR.MK/MLADI

MODELET E VLERËSIMIT

Vlerësimin e propozim-projekteve do ta bëjë komisioni i përbërë nga persona të jashtëm profesional.

BUXHETI I PËRGJITHSHËM I THIRRJES

185 MILION DENARË

AFATI PËR APLIKIM NË THIRRJEN E PARË

11 QERSHOR 2018, DERI NË ORA 23:59

MBËSHETJA PROFESIONALE

Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik ofron mbështetje/edukim profesional për aplikuesit potencial (kontakt tel. 02 3145 – 258, e-mail: info@fitr.mk).

INSTRUMENTET E MBËSHETJES

ÇFARË SHPENZIME MUND TË FINANCOHEN?

Në kuadër të projekteve investuese mund të financohen lloje të ndryshme të shpenzimeve, mes të cilave edhe këto në vijim:

- Shpenzime për furnizim, hua dhe/ose ndërtim të pajisjeve dhe sallave, përpunim të softuerit, veglave të teknologjisë informatike dhe llojeve të ndryshme të mjeteve, në lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e projektit për zhvillim teknologjik;
- Shpenzime që kanë të bëjnë me marrjen e certifikatave për kualitet, marrje të patentave dhe të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale, si dhe dokumente të tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet investuese, që jepen nga subjekti i certifikuar.
- Bruto pagesa (për personat e punësuar tek Shfrytëzuesi) (vetëm për instrumentin 3)
- Furnizim ose/ose huazim të pajisjes dhe materialeve harxhuese për hulumtim dhe zhvillim; si dhe shërbime nënkontraktuese për hulumtim dhe zhvillim (p.sh. testim, shërbime laboratorike etj.);
- Angazhim të konsulentëve për ekspertizë që kanë të bëjnë me menaxhim investues, menaxhim financiar, mobilizim të mjeteve, zhvillim të biznesit, marketingut, çështjeve juridike, mbrojtjes së pronësisë intelektuale etj;
- Shpenzimet që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe realizimin e planit për përfundim të aftësive profesionale dhe teknike;
- Shpenzime për aplikim, kotizim dhe kompensime të tjera për pjesëmarrje në program për përsosmëri profesionale dhe/ose praktikë që e paguan Organizatori
- Shpenzime tjera të lidhura drejtpërdrejtë me realizimin e projektit për zhvillim teknologjik, inovacione ose përsosmëri profesionale

DASHI 21. mars - 20. prill

Kjo e premte do të shkëlqejë si në dashuri edhe në sektorin profesional.

DEMI 21. prill - 21. maj

Dita do të rezultojë me angazhime të shumta. Arsyeya? Thjeshtë dhje vetëm, pasi mund të jetë një "e premte e zezë".

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Kjo e premte nuk do të jetë aspak e keqe, ndonëse në momente të caktuara mund të hasni në vështirësi që duhen kaluar.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Gjatë kësaj dite do të dominojë fati i mirë, kryesisht në sferën e ndjenjave. Parashikimi i ditës parashikon një rigjallërim të dashurisë dhe takime të kënaqshme me personin e zemrës.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do të jetë një ditë e shkëlqyer, thuajse në çdo gjë. Në dashuri, nëse po përjetoni një lidhje sentimentale të lumtur, mos i vini limite fantazisë dhe mos e refuzoni imagjinatën e partnerit/es.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Kjo e premte nuk do të jetë aspak në ritme të kënaqshme. Në lidhjen në çift, kërkohet që të ruani sa më shumë veten.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Kjo e premte do të jetë një nga ato ditë që duhet të kalojnë sa më shpejtë. Në dashuri, nuk do të jeni në gjendje që të krijoni një atmosferë argëtuese.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo ditë do të nisë mjaft mirë për të lidhurit e kësaj shenje. Në dashuri, raporti juaj në çift do të shkojë më së miri, tamam siç ju e dëshironi.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Kjo e premte do të favorizojë mirëqenien tuaj. Në dashuri raporti juaj në çift do të shënojë përmirësime të vogla, por vendimtare.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Do të jetë një ditë relativisht e qetë. Në dashuri gjatë kësaj të premte, do të zbuloni shijen e të bërit të gjërave që ju pëlqejnë, sidomos me personin që doni.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Do të jetë një ditë mjaft e mirë. Në fushën sentimentale situata do të jetë shumë më harmonike dhe yjet parashikojnë që raporti në çift do të jetë plotë surpriza, përkëdhelje dhe ndjenja të forta.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Kjo e premte do të nisë më së miri. Sa i takon dashurisë, do të kaloni një mbrëmje të kënaqshme në shoqërimin e parnerit/es. Organizoni diçka ekskluzive për të jetuar në maksimum këtë moment.



Grid for the crossword puzzle with clues like 'HARMONIA, ARGËTIMI', 'KOHJA', 'AKTORJA AMERIKANE NGA FOTO', etc.

FJALËKRYO KLASIK

Grid for the word search puzzle with numbers 1 through 29 indicating starting points.

HORIZONTALISHT: 1. Shtyj dikë me fjalë a me vepra që të bëj diçka; 5. Automobilisti brazilian, Ajrton; 8. Barkë e madhe me fund të sheshtë (shum.); 10. Kam qenë; 12. Zero, litër; 13. Emër femre (pashq.); 15. Trup gjeometrik; 16. Lloj sallate me kos; 18. Që ka të bëjë me klerin; 20. Që ka të bëjë me protezën; 22. Mbret, perandor (lat.); 23. Emër i lashtë i banorëve të Myzeqesë (shq.); 24. Kampion; 25. Showmani ynë, Krasta; 26. Lutje e gjatë fetare kishtarë; 28. Fluturues i parë (mit.); 29. Sëmundje ngjitëse.

VERTIKALISHT: 1. Mbret nga epi hindus Mahabharata; 2. Shkruaj; X.U.; 3. Mëritë; 4. Portier brazilian; 6. Aktorja australiane, Kidman; 7. Një ditë e caktuar në kalendarin mysliman; 8. Pjesë kryesore e një limani; 9. Lloj pëlhure sintetike; 11. Liman në Suedi; 14. Shkëmb sipërfaqësor pëlcitës; 17. Forca, fuqia; 18. Huamarje e parave nga banka; 19. I logjikës; 20. Atëherë, në atë rast; 21. Shkronjë e alfabetit grek; 24. Afirmacion çek; 27. Abdyl Frashëri.

NJË KURS PËR MASTURBIMIN!

Klasa e re në universitet shkaktonte debate



Përmes kurseve të veçanta, shumë universitete synojnë që të përgatisin sa më mirë studentët e tyre, jo vetëm në fushën që vazhdojnë studimet. Por, një

universitet në Gjermani e ka tepruar. Universiteti i Bielefeldit është vënë në qendër të kritikave pas hapjes së një kursi disamujor ekskluzivisht për fem-

rat. Bëhet fjalë për një klasë ku do të ofrohet në "teori dhe praktikë" sesi studentet të kënaqin veten, pra të masturbojnë. Aq "seriozisht" e kanë marrë pedagogët këtë kurs, sa u kanë kërkuar studenteve që kërkojnë të regjistrohen në këtë kurs të marrin me vete një pasqyrë të vogël, peshqir dhe lubrifikant. Klasa në fjalë është një nismë e "papjekur" e një grupi studentësh dhe financohet nga Komiteti i Përgjithshëm i Studentëve në këtë universitet. Kjo ka ngjallur kritika nga pjesa më konservatore e studentëve dhe nga organizata të ndryshme, por vetë drejtuesit e Universitetit thonë se nuk kanë në plan ta mbyllin këtë klasë. "Nuk vendosim në përmbajtjen e eventeve të propozuara nga studentët", deklaroi një zëdhënës i Universitetit.



Sherri për qoftet, Suedia e pranon: Qoftet suedeze janë turke

Suedia i ka dhënë fund një debati të hershëm dhe të pazakontë që pushtonte hera-herës opinionin publik. Bëhet fjalë për origjinën e një varianti qoftesh, që për shumë suedeze janë pjesë e kuzhinës tradicionale të tyre. Por, përmes një postimi në Twitter vetë sweden.se, që është edhe faqja zyrtare e internetit për vendin nordik i ka dhënë fund këtij debati. "Qoftet suedeze bazohen në një recetë që Mbreti Çarls XII e mori nga Turqia, në fillim të shekullit të 18-të. Le t'u qëndrojmë fakteve!", thuhet në cicërimën e shkurtër. Megjithatë, duke dashur që të shua një debat, postimi ka ndezur pa dashje një tjetër. Shumë suedeze nisën të pyesnin nëpër rrjetet sociale se cilat ushqime të tjera, që ata deri më sot i konsiderojnë tradicionale të tyre në fakt mund të jenë turke dhe çfarë do të thotë kjo për Ikea-n rrjetin e famshëm suedez të shpërndarjes dhe shitjes së këtyre qoftëve tradicionale.



Rreziqet nga fjetja me flokë të lagur

Këshillohet gjithmonë të mos shtrihen të flini me flokët e lagur. Kjo sepse rrezikoni të ftoheni apo të mund të merrni ndonjë pneumoni. Në vijim lexoni disa nga rreziqet që vinë nga fjetja me flokë të lagura:

- Dhimbje koke. Fjetja me kokën lagur mund të shkaktojë dhimbje koke. Kjo ndodh pasi gjatë gjumit temperatura e trupit rritet duke krijuar një çrregullim ndërmjet temperaturës së sipërfaqes dhe lagështisë së flokëve. Të nesërmen në mëngjes mund të zgjoheni me dhimbje koke.

- Infeksione. Jastëku është ajo

pjesë e shtrojës ku akumulohen bakteret, qelizat e vdekura të lëkurës, vajrat e trupit të njeriut dhe papastërtitë e tjera nga mos pastrimi i grimit, transmeton ksp. Kontakti i drejtpërdrejtë i flokëve të lagura me jastëkun krijojnë terrenin perfekt për zhvillimin e infeksioneve të ndryshme që stimulohen edhe nga përmbajtja yndyrore e balsamit.

- Këputja e flokëve. Fjetja me flokë të lagur ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë fenomen. Ku flini me flokë të lagur dhe aq më tepër të pakrehur, flokët ngjiten me njëri-tjetrin dhe këputen.

TESLA PËRGATIT MAKINËN MË TË SHPEJTË NË BOTË?!



Për të arritur shpejtësinë prej 100 km në orë, një supermakine si Porsche Spyder do t'i nevojiteshin 2.8 sekonda; Për një Lamborghini 2,7 sekonda; Për një Bugatti Veyron do nevojiteshin 2.4, e po aq do t'i duheshin edhe një makine të rrallë si Koenigsegg. Por këto nuk janë asgjë para 2.1 sekondave që Tesla pretendon se makina e saj e re do të arrijë. "Tesla Roadster" mund të arrijë një shpejtësi maksimale

prej 400 km në orë, si edhe brenda 2.1 sekondave të arrijë shpejtësinë prej 100 km në orë, ashtu si asnjë makinë tjetër. E nëse këto të dhëna do të rezultojnë të suksesshme, pa më të voglin dyshim ajo do të konsiderohet si makina më e shpejtë në botë, por ky nuk është avantazhi i vetëm i saj. Si një prodhim i Teslas, synimi i së cilës është zhdukja e karburantit tradicional nga makinat, edhe ky model

do të jetë me energji elektrike, e do të përshkruajë me një karikim 1000 km. E kush nuk do ta donte një makinë të tillë, kur çmimi i porosisë për versionin bazë të saj është 43.000 euro. Por fanatikët e makinave nuk do ta porosisnin kurrë atë, pasi për ta do të jetë versioni "Founders Series", vetëm 1000 të tilla, porositë për të cilat kanë filluar që tani. Për një çmim "modest" prej 215 mijë euro.

553 - Hapet Këshilli i dytë i Konstantinopojës
1260 - Kublai Khan shpallet sundues i Perandorisë mongole
1382 - Beteja e Beverhoutsveld - popullata mund ushtrinë e dehur
1646 - Mbreti Çarls I dorëzohet në Skoci
1762 - Rusia dhe Prusia nënshkruajnë traktat të paqes
1821 - Vdes Perandori Napoleoni I në ekzil në ishullin Shën Elena në jug të Oqeanit Atlantik
1920 - Trupat polake okupojnë Kievin
1920 - Presidenti amerikan Wilson shpall Partinë komuniste të punës ilegale
1936 - Trupat italiane okupojnë Adis Abeben
1944 - Gandhi lirohet nga burgu
1949 - Formohet Këshilli i Evropës
1980 - Konstantin Karamanlis zgjidhet kryetari i Greqisë për herë të parë.


KALENDARI HISTORIK 3 MAJ

"Rhythm" është fjala më e gjatë që nuk përmban asnjë zanore në gjuhën angleze.


Rhythm.



Çokollata mund t'i vrasë qentë sepse ajo përmban theobromin, i cili prek zemrën dhe sistemin nervor.



Uji i nxehte konvertohet në akull shumë më shpejt se i ftohti.



Në vitin 1878 libri i parë me numrat e telefonit në botë është përbërë vetëm prej 50 emrave

Provimi
Babai: Bir, a i ke ditur pyetjet në provim?
Djali: Po, babi!
Babai: E pse ke rënë nga provimi, biri im i dashur?
Djali: Nuk i dija përgjigjet, babi...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Mënyra më e mirë për të mbajtur fjalën është të mos e japësh.

(Napoleon Bonaparti)